



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Inxhinierinë Matematike”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

Universiteti Politeknik i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Elida Hoxha

2. Dr. Dolantina Hyka

Tetor 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” ofruar nga
Universiteti Politeknik i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Matematike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Inxhinierinë Matematike
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr. 9275 Prot, datë 27.12.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 220, datë 12.05.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (2023- 2024)	31 PAE/ 3 PAK
18	Numri i studentëve:	50 studentë (3 vitet e fundit)
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” ofruar nga Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) është një program akademik tre-vjeçar që synon të përgatisë studentët me njohuri dhe aftësi të thelluara në fushën e inxhinierisë matematike. Ky program është organizuar në Departamentin e Inxhinierisë Matematike në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF), dhe përmban një total prej 180 kreditesh ECTS, duke siguruar një formim të plotë në disiplinat e matematikës dhe aplikimeve të saj inxhinierike.

Stafi akademik i programit përbëhet nga 31 profesorë të përhershëm (PAE) dhe 3 profesorë të përkohshëm (PAK), duke përfshirë dy profesorë të nderuar me titullin Prof. Dr., 13 profesorë të asociuar (Prof. Asoc. Dr.), 12 doktorë shkencash (Dr.), dhe katër masterë shkencorë (MSc). Kjo përbërje garanton një cilësi të lartë të mësimdhënies dhe një mbështetje të fortë akademike për studentët.

Programi është i licencuar nga autoritetet përkatëse, duke përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe akademike për ofrimin e tij.

Programi zhvillohet plotësisht në gjuhën shqipe dhe është strukturuar për të ofruar një formim të gjithanshëm në teorinë dhe praktikën e inxhinierisë matematike, me një fokus të veçantë në aplikimet praktike të matematikës në fusha të ndryshme të inxhinierisë dhe teknologjisë. Ky formim siguron që studentët të jenë të gatshëm për tregun e punës dhe për ndjekjen e studimeve të mëtejshme në nivel të avancuar.

Në përfundim të programit, studentët pajisen me një diplomë Bachelor në Inxhinierinë Matematike, që u jep atyre mundësinë të aplikojnë për pozicione të ndryshme në industri, kërkim shkencor dhe sektorin publik, ose të vazhdojnë studimet në programe master dhe doktorature brenda dhe jashtë vendit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

GVJ përbëhet nga dy anëtarë: Prof.Dr. Elida Hoxha dhe Dr. Dolantina Hyka. Koordinator teknik për ASCAL në këtë procedurë vlerësimi është Msc. Aviola Bardhi.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke patur në konsideratë kompetencat profesionale në lidhje me fushën e këtij programi studimi, eksperiencën e tyre në vlerësime të programeve të studimit, integriteti profesional, mungesa e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykim dhe në vlerësim.

GVJ, në punën e tij, ka shfrytëzuar "Raportin e vlerësimit të brendshëm" të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), i ngritur pranë Departamentit të Inxhinierisë Matematike, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, si dhe dokumentacionin në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) që shoqëronte këtë raport. Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësish të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Të dhënat e vëna në dispozicion përmes DVV u diskutuan dhe u verifikuan gjatë takimeve vlerësuese të zhvilluara 10-11 Qershor 2024, në kujdesin e koordinatorit teknik të ASCAL. Institucioni kishte marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të takimeve, në përputhje me agjendën e vizitës.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur dhe diskutuar gjatë takimeve me përfaqësuesit e Institucionit.

Më datë 19.09.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr 38/42 Prot., datë 19.09.2024 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 30.09.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr 2265/6 Prot., datë 02.10.2024, ardhur në protokollin e ASCAL më datë 04.10.2024.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:

Komenti i IAL: Nuk janë 50 student të regjistruar por janë 66 në total.

Përgjigja e GVJ: Nga vizita në institucion, numri i studentëve të regjistruar për herë të parë dhe të pa çregjistruar është 50 ndërsa numri si studentëve të regjistruar për herë të parë në total është 66 perkatesisht sipas viteve 2021-2022 regjistruar për herë të parë 44 student, ne 2022-2023 janë 13 student dhe ne 2023-2024 janë regjistruar 9 student. Vetëm vitin e fundit 4 prej tyre janë çregjistruar sipas regjistrave të verifikuar në sekretarinë mësimore. Pra shifra e dhënë 50 i referohet numrit të studentëve të regjistruar për herë të parë dhe të pa çregjistruar nga programi i studimit në shqyrtim. Nëse do i referohemi studentëve të regjistruar për herë të parë pavarësisht nëse janë çregjistruar apo jo, atëherë numri i tyre është 66. Studentë aktiv në vitin 2023-2024 janë 79 sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga GVB.

GVJ sqaron se në tabelën përmbledhëse (faqa 2 e raportit) vendosen numrat e studentëve që regjistrohen për herë të parë në programin e studimit.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinierinë Matematike”

I. OFRIMI PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në misionin e tij UPT ka promovimin e vlerave kombëtare dhe ofron programe studimi në përputhje me standartet akademike dhe profesionale që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe me misionin e objektivat <i>Evidenca 1, 3</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” ofrohet në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar dhe rajonal. Ai në të gjithë elementët e tij bazohet në dokumentacionin bazë të UPT. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, UPT dhe FIMIF, të shprehur në statutin e Universitetit, në strategjinë e zhvillimit të tij, në strategjinë e zhvillimit të FIMIF dhe në planin strategjik të zhvillimit të Departamentit të Inxhinierisë Matematike. Fusha e studimit të programit të studimit përputhet me fushën e veprimtarisë së departamentit të Inxhinierisë Matematike të këtij institucioni <i>Evidenca 1, 3, 12, 29.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UPT – FIMIF. Ai është organizuar në përputhje me Statutin dhe rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënien në UPT dhe në zbatim të akteve të tjera nënligjore. Kjo përputhshmëri vihet re në rregulloren e programit të studimit, Planin mësimor, syllabuset e këtij programi studimi. Drejtimit akademike të UPT janë formimi i specialistëve në fushat inxhinierike. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” është në përputhje me këtë drejtim pasi synon të formojë specialistë në fushën e inxhinierisë matematike, të cilët formimin inxhinierik e ndërthurin me teknikat moderne të matematikës për modelimin dhe zgjidhjen e problemeve inxhinierike. <i>Evidenca 1, 12, 98, 99, 100.</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi	Universiteti Politeknik i Tiranës, i akredituar institucionalisht, fillimet e tij i ka në vitin 1951 dhe është krijuar si universitet Politeknik nga VKM Nr. 215, Dt. 15.7.1991 “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” dhe është Institucion publik i Arsimit të Lartë. UPT ka një përvijë 73 vjeçare në ofrimin e programeve të studimit që




studimi në atë fushë.	formojnë inxhinierë të fushave të ndryshme UPT është i organizuar në tetë njësi kryesore: Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës; Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave; Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike; Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike; Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike; Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit; Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit; Instituti i Gjeoshkencave. UPT ka të gjithë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike, për ofrimin e një programi studimi në fushën e Inxhinierisë Matematike. Në njësitë bazë përbërëse të njësive kryesore ofrohen programe studimi të të tre cikleve të studimit, duke plotësuar kërkesat ligjore përsa i përket burimeve njerëzore dhe kapaciteteve. UPT është IAL i akredituar institucionalisht për një periudhë 6 vjecare. UPT plotëson kriteret ligjore të LAL 80/2015, të personelit akademik me titull akademik “Profesor”, për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Titujve Akademik, KPPA, për dhënien e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”. Me ngritjen e këtij komisioni në dhjetor 2019, UPT është duke promovuar personelin akademik të UPT dhe Universiteteve të tjera publike dhe private për fitimin e titujve akademik. FIMIF me personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si edhe me infrastrukturën e tij ka kapacitetet e duhura për ofrimin e programeve të studimit që ai mbulon. Nga studimi i dosjes dhe takimet nga vizita në institucion, mund të themi se Departamenti i Inxhinierisë Matematike, njësia bazë, që ofron programin e studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” plotëson kriteret ligjore të LAL 80/2015. DIM është pasardhës i Departamentit të Matematikës dhe Informatikës të krijuar në 1992 menjëherë kur u hap UPT. Ky departament ka qënë dhe është aktiv si në fushën e mësimdhënies ashtu dhe në fushën e kërkimit shkencor. Departamenti ka ofruar programe studimi në të tre ciklet e studimit. Programet e Doktoratës kanë funksionuar në vitet 2009-20019 dhe janë propozuar të rihapen këtë vit akademik të riorganizuara. Gjithashtu DIM jep kontributin e tij në të tre ciklet e studimit në të gjithë fakultetet e UPT. Aktualisht DIM në përbërje të tij 30 PAE (5 Prof.Dr, 10 Prof.Asoc.Dr, 12 Dr., 1 dr në proces, 2 MSc) dhe 35 PAK (3 prof.Dr, 4 prof.Asoc.Dr, 7 Dr, 21 MSC DIM ka infrastrukturën e nevojshme akademike dhe laboratorike për të mbështetur këtë program studimi Nga vizita në FIMIF vumë re se FIMIF ka salla të pajisura me mjete të nevojshme teknologjike, kompjuter, projektorë, tabela etj. Atje ishin funksional dhe të mirë pajisur laborator i informatikës, laborator i Matematikës së Aplikuar dhe kërkimit shkencor, laborator i fizikës së përgjithshme, laborator i fizikës speciale, laborator i kimisë
-----------------------	--

	dhe laborator special i kimisë. <i>Evidenca 3, 21, 24, 56, 61, 74, 116</i>			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Referuar dokumentacionit GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” është në përputhje me fushën akademike të FIMIF, e cila është njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. <i>Evidenca 28, 29, 88, 98</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitës në institucion vëren se institucioni ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Program i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” ofrohet nga DIM në FIMIF dhe është në përputhje me misionin e institucionit dhe me fushën e veprimtarisë. DIM dhe FIMIF kanë kapacitetet akademike dhe infrastrukturore për ofrimin e këtij program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” ofrohet nga DIM në bashkëpunim edhe me departamentet e tjera të FIMIF. Për mbarëvajtjen e PSBIM në përputhje rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënien në UPT, rregullore e PSBIM dhe rregullores së DIM ngrihen dhe funksionojnë e bashkëveprojnë strukturat e duhura si Grupet mësimore/kërkimore, Këshilli i Programit të studimit, përcaktohet koordinatori i programit të studimit. DIM ofron shërbimin e vet edhe në zhvillimin e lëndëve matematike në programe të ndryshme studimi të ofruara nga UPT. Për të harmonizuar procesin mësimor në disiplinat e formimit bazë (Matematikë, Fizikë, Kimi) dhe lëndën e gjuhës së huaj në fakultetet e tjera të UPT-së, në FIMIF ngrihen “grupet Fakultetore, në përputhje me rregullore e FIMIF. Grupi ndërfakultetor është njësi ndihmëse në fakultet, në përbërje të një departamentit dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor në lëndët e formimit bazë. Në rregulloret e përmendura më sipër përcaktohen edhe detyrat e secilin organ dhe drejtues.

	Strukturat administrative dhe akademike të institucionit bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Bashkëpunimi bëhet në kuadër të mësimdhënies, shkëmbimit të stafit akademik, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare. Detyrat e stafeve janë të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse të departamenteve, fakulteteve si dhe të njësive administrative në shërbim dhe në ndihmë të realizimit të programit të studimit. Raportimi për përmbushjen e detyrave bëhet në mënyrë periodike dhe për këtë ekziston një strukturë hierarkike. <i>Evidenca 12, 28, 88, 98.</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	Nga vizita në Institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për të realizuar objektivin e tij strategjik në rritjen e njohjes ndërkombëtare të diplomave universitare të lëshuar nga UPT, në të gjitha ciklet e studimit; zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve njerëzore, IAL ka vendosur marrëdhënie kontraktuale me aktorë të ndryshëm brenda ose jashtë vendit. Gjatë viteve të fundit janë realizuar marrëveshje me IAL të huaja në kuadër të projekteve Erasmus+, nga të cilat kanë përfituar si stafet e reja akademike ashtu dhe studentët. Gjithashtu DIM është nismëtar i disa marrëveshjeve me institucione shtetërore dhe biznese si, Qendra Spitalore “Nënë tereza”, Albepetrol SH.A. Albania, Fier bankers petroleum Albania, ltd, dhe disa kompani private. Këto marrëveshje bëhen në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore, për efekte të kërkimit shkencor, në hartimin e punimeve të diplomave të të tre niveleve të studimit, si dhe për të ndihmuar studentët në gjetjen e një vendi pune. <i>Evidenca 5, 46, 47, 48.</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Nga verifikimi rezulton se UPT ka marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi zyrtare për program studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike”, si marrëveshje me INSTAT, Star Albania SH.P.K. DIM bashkëpunon ngushtësisht me këto institucione për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale. Studentët përfshihen edhe në aktivitete sezonale të këtyre kompanive. Në fund të programit të studimit studentët mund të punësohen në këto institucione. <i>Evidenca 6.</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia kryesore FIMIF dhe Njësia bazë DIM që ofrojnë programin e studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” në mënyrë periodike bëjnë analizën e përfitimeve nga këto marrëveshje. Këto informacione ndahen me drejtorinë e kërkimit shkencor dhe projekteve, Drejtorinë e Sigurimit të Cilësisë, drejtorinë e komunikimit dhe koordinimit, zura Alumni, si edhe me studentët e vitit të parë të studimeve. <i>Evidenca 39.</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si edhe me bisedat me stafin akademik dhe studentët e këtij program studimi, vihet re se UPT ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private të vendit apo të huaja për :</i> <i>Për trajnimin profesional të stafit të ri akademik marrëveshje në kuadër të projekteve Erasmus +. Nga këto marrëveshje kanë përfituar edhe studentët.</i>

	<i>Për kryerjen e praktikave profesionale dhe temave të diplomave të të tre cikleve të studimit duke ndikuar në punësimin e studentëve në perfundim të këtij program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga dokumentacioni i paraqitur, programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” është i organizuar në lëndë e module . Plani mësimor përbëhet nga 29 veprimtari formuese. Të gjitha lëndet kanë kodet e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë të përcaktuar në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.1.2018, i ndryshuar. PSBIM është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti, nga një student që ndjek këtë program studimi është 60 kredite. Programi ofrohet me 180 ECTS, me kohëzgjatje të normale të parashikuar 3 (tre) vite akademike. Kontrolli i dijeve në këtë program studimi bëhet nëpërmjet vlerësimit të provimeve të ndërmjetme, vlerësimit të detyrave/projekteve të kursit, vlerësimi i punëve të laboratorit, vlerësimi i aktivizimit dhe frekuentimit dhe vlerësimit përfundimtar që është provimi. Cdo lëndë e këtij programi shlyhet me provim dhe për 3 vite studentët japin 28 provime, pa llogaritur mbrojtjen e diplomës. Provimi përcakton rreth 70% të vlerësimit. Përqindjet janë relative në varësi të lëndës. Në syllabuset e secilës lëndë janë të përcaktuara rezultatet e të nxënësve dhe kompetencat profesionale. Komponentët e veprimtarive formuese, leksione, seminare, laboratore janë të përcaktuara në planin mësimor dhe në syllabuset e secilës lëndë duke përcaktuar edhe ndarjen e krediteve për secilin komponent. Lëndet në programin mësimor janë të ndara në kategori në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.1.2018, i ndryshuar. Në dokumentacionin e paraqitur jepen edhe mënyrat e miratimit të kriterëve dhe kuotave të pranimit, ndarja në grupe mësimore, syllabuset e secilës lëndë, forma e diplomës dhe suplementit. Detyrimi përmbysës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e provimit të formimit ose për studentët me mesatare më të lartë është mundësia edhe e temës së diplomës. Mësimi realizohet në gjuhën shqipe. <i>Evidenca 99, 100, 105</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike”, si: plani mësimor, syllabuset, Rregullorja e programit të studimit, si dhe gjatë takimit me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se ky program studimi u ofron studentëve njohuri shkencore dhe profesionale të matematikës së zbatuar për analizën dhe zgjidhjen e problemeve konkrete inxhinierike. Shihet qartë që programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh, si në IT,

të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	në fizikë, kimii, ekonomi, informatikë etj Gjatë programit të studimit merren njohuri matematike pranë fushave inxhinierike si, Analizë numerike, ekuacione diferencilë dhe me derivate të pjesshme si edhe një grup lëndësh inxhinierike të matematizuar si Bazat e elektronikës, Bazat e automatikës etj, që e pajisin studentin me njohuri tipike inxhinierik për tu përballur me modelime dhe probleme komplekse. Njohuritë e marra në këtë program studimi janë një bazë e mirë edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit në Inxhinierinë Matematike apo në ndonjë program të afërt me të.. Programi u përgjigjet kërkesave, me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional. Njohuritë e marra janë bashkëkohore dhe të krahasueshme me nivelin e njohurive që jepen në programe të ngjashme inxhinierike në universitete të tjera. DIM ka pasur si model në ofrimin e këtij programi studimi programet e tilla në Universitetet e Torinos, Milanos por edhe të Universitetit të Kalifornisë, SHBA dhe Universitetit të Bristolit, UK. [Evidenca 91. Programe studimi të ngjashme]. Në përfundim të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinierinë Matematike”, studentët kanë përfituar aftësitë teorike dhe praktike të nevojshme për të trajtuar problematikat e ndryshme inxhinierike me metoda moderne matematike. Synohet që studentët të zhvillojnë idetë dhe aftësitë e tyre në zgjidhjen e problemeve inxhinierike të jetës reale nëpërmjet punës së pavarur të tyre me detyrat/ projektet e kursit, labororet e praktikat profesionale. Gjithashtu ky program studimi i krijon studentit hapësirën e mjaftueshme për thellimin e dijeve në disiplina, ku ai shpreh interes. Kjo realizohet nëpërmjet të drejtës të studentit për të zgjedhur, lëndët me zgjedhje sipas planit mësimor. Nga takimet me stafin akademik dhe studentë të këtij programi studimi, GVJ konkludon se njohuritë e marra e aftësojnë studentin për t’u integruar në kohë të shkurtër në kompanitë e ndryshme të profilit brenda dhe jashtë vendit dhe hedh bazat për zhvillimin e studimeve më të avancuara. Studentë u shprehën të kënaqur me aftësitë e marra gjatë këtij programi studimi dhe në përgjithësi ishin të punësuar me kohë të pjesshme në kompani private. <i>Evidenca 91, 98, 99, 100.</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Plani mësimor, i programit të studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” i ka lëndët e grupuara sipas kategorive të veprimtarisë: 1. lëndë bazë (A) – 36 kredite, (20%), 2. lëndë karakterizuese (B) – 93.5 kredite, (52 %), 3. lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 24 kredite, (13.34%), 4. lëndë plotësuese (D) – 19.5 kredite, (10.84%), 5. detyrime përmbyllëse (E) – 7 kredite, (3.82%) Kreditet e grumbulluara për çdo kategori janë brenda raporteve të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi. <i>[Evidenca105, Tabelat e RVB], [Evidenca99 Plani mësimor].</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës	Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” gjendet lënda Praktikë mësimore në kategorinë D me 6.5 kredite, me 130 orë faktike. Kjo lëndë zhvillohet për 14 javë në

profesionale dhe të detyrimeve përmbyllesë.	semestrin e dytë të vitit të tretë me 6.5 orë në javë . Si detyrime përmbyllesë, në planin mësimor është parashikuar lënda e emëruar Punim diploma/ provim final, e kategorisë E me 7 kredite, me ngarkesë 35 faktike e planifikuar për 14 jave në semestrin e dytë të vitit të tretë. Opsioni provim diploma është parashikuar vetëm për studentë që kanë mesatare mbi 7. Pjesa tjetër e studentëve i nënshtrohet provimit final.			
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” është shpallur prioritet kombëtar me VKM 386, dt. 01.06.20022 i ndryshuar. Pranimi i studentëve në këtë program studimi është bërë në përputhje me ligjin e AL dhe aktet e tjera nënligjore duke zbatuar statusin e vecantë të financimit			
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Ky program studimi ofrohet vetëm nga DIM në UPT dhe në asnjë universitet tjetër brenda vendit. Që në hapje të tij ai ka ngjashmëri me programet e njëjta në Universitetin e Torinos dhe të Milanos. Ka studentë të këtij program studimi që kanë vazhduar studimet e ciklit të dytë në këto universitete.			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	UPT, FIMIF dhe DIM kanë zbatuar procedurën ligjore në lidhje me kodimin e programit të studimit në bazë të Udhëzimit nr.31, dt. 15.11.2022, “Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL në RSH”. PSBIM ka propozuar kodin 63BA0719S në shkresën e UPT nr.132/8 të dt 31.03.20023 drejtuar MAS. <i>Evidenca 104.</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	PSBIM nuk është program i përbashkët ndërmjet dy apo më shumë IAL. Ai ofrohet vetëm nga UPT, FIMIF, DIM.			
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit PSBIM ofrohet nga DIM në FIMIF të UPT në përputhje me Ligjin mbi AL dhe aktet e tjera nënligjore. Ai është i organizuar në lëndë/module të ndara në kategori formuese, të vlerësuara me kredite dhe të ndara sipas komponenteve leksion, seminar, laboratorëtj. Në të është parashikuar realizimi i praktikës mësimore dhe detyrimet përmbyllesë si provim final apo temë diploma. UPT ka dërguar në MAS propozimin për kodimin e këtij program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Universiteti Politeknik i Tiranës, është Institucion Publik i Arsimit të lartë i akredituar, fillimisht me Vendimin e Bordit të Administrimit, BA, Nr. 13, datë 07.04. 2017 dhe riakredituar nga BA me Vendimin Nr. 01, datë 07.01.2022, për periudhën 07/01/2022 deri në 06/01/2028 FIMIF është njësi kryesore në UPT dhe është hapur me VKM Nr. 824, datë 05.12.2007 “Për krijimin e disa njësive kryesore, fakultete në Universitetin Politeknik të Tiranës”. FIMIF plotëson kriteret ligjore të përcaktuara nga Ligji nr 80, dt. 22.07.2015 “për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH” dhe Udhëzimin nr.27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në IPAL”. FIMIF ka në strukturën e vet 4 njësi bazë, departamentin e Inxhinierisë Matematike, departamentin e Inxhinierisë fizike, Dpartamentin e Inxhinierisë Kimike dhe Qendrën e Gjuhëve të huaja. FIMIF ka në perbërje edhe njësitë ndihmëse, Sekretarinë mesimore, Degën e Financës, Degën e Sigurimit të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. FIMIF ka strukturë akademike në përputhje me nr.27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në IPAL. Në të funksionojnë Asambleja e Personelit Akademik, Dekanati, Dekani dhe zëvendës dekanët. Numri i përgjithshëm i personelit akademik i FIMIF gjatë vitit akademik 2023-2024 është 138, ku 70 janë personel akademik me kohë të plotë, 7 personel ndihmës akademik me kohë të plotë, 61 personel akademik me kontratë ose i ftuar. Kualifikimet, titujt dhe gradat e personelit akademik të FIMIF janë dhënë ne tabelat e RVB Njësia Bazë, përgjegjëse për PSBIM është DIM, i cili ka 30 staf akademik të punësuar me kohë të plotë. Sipas tabelave 1.1, 1.2, 1.3 të RVB, stafi akademik i DIM sipas viteve akademike është si më poshtë: Gjatë vitit akademik 2023-2024, DIM ka 30 staf akademik me kohë të plotë (5 prof.DR, 10 prof.Asoc.Dr, 12 Dr, 3 MSC) 35 Staf me kontratë (3 Prof.Dr, 4 prof.Asoc.Dr, 7 Dr, 21MSC Gjatë vitit akademik 2022-2023, 30 staf akademik me kohë të plotë (5 prof.DR, 3 prof.Asoc.Dr, 19 Dr, 3 MSC) 38 Staf me kontratë (4 Prof.Dr, 2 prof.Asoc.Dr, 10 Dr, 22MSC Gjatë vitit akademik 2021-2022,

	31 staf akademik me kohë të plotë (5 prof.DR, 2 prof.Asoc.Dr, 11 Dr, 23 MSC) 41 Staf me kontratë (3 Prof.Dr, 4 prof.Asoc.Dr, 7 Dr, 21MSC) FIMIM dhe DIM përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>Evidenca 105, tabelat e RVB.</i>			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	FIMIF ka të angazhuar 7 personel ndihmës akademik me kohë të plotë për realizimin e moduleve laboratorike dhe praktikave mësimore. Secili prej tyre është specialist në një laborator të FIMIF, ku ndihmon në mbarrëvjtjen e procesit mësimor për modulet laboratorike. Pranë DIM është angazhuar 1 staf ndihmës akademik me kohë të plotë, specialist i dy laboratorëve kompjuterikë. Në përputhje me Nenin 15 të Rregullores së PSBIM, praktika mësimore e studentëve ndiqet nga një pedagog përgjegjës që mban lidhje me institucionin publik apo privat ku studenti kryen praktikën. Në perfundim të praktikës studenti përgatit relacion për punën e kryer i cili vlerësohet nga komisioni i ngritur me notë. Kryesisht studentët që angazhohen në bërjen e diplomave mund ta bëjnë praktikën mësimore edhe në laboratorët kompjuterikë të DIM, të cilët kanë infrastrukturën e duhur për këtë. <i>Evidenca 96, 98.</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të Rregullores së FIMIF [Evidenca28, Rregullore e Brendshme e FIMIF], për çdo program studimi ngrihet KPS. Nga biseda me DIM dhe përgjegjësin e Dim rezultoi se ishte ngritur KPS dhe si koordinator i PSBIM ishte caktuar nga përgjegjësi i DIM, <i>por nuk kishte vendim mbi caktimin e tij si koordinator.</i> Në baze të Rregullores së sipërcituar, koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit dhe praktikave profesionale. Koordinatori i programit të studimit dhe KPS informojnë vazhdimisht drejtuesin e departamentit dhe bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, në përputhje me rregulloren e njësisë bazë dhe kryesore			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore FIMIF dhe Njësia bazë DIM plotësojnë kriteret ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, stafet ndihmëse për praktikën dhe modulet laboratorike për vlerësimin dhe akreditimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike pranë FIMIF, i cili disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në arkivin e DIM dhe të FIMIF ishin të depozituara dhe të dokumentuar Rregullore e FIMIF, Rregullore e DIM, Rregullore e PSBIM. Në DIM, përvec dokumentacionit të mësipërm, janë të arkivuara plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese në gjuhët shqip dhe anglisht, informacionin e plotë sipas secilës lëndë që ju jepet studentëve, si librat bazë, leksionet e shkruara, detyrat dhe projektet e realizuara nëviin e fundit akademik, Cv e personelit akademik dhe Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënje në këtë program studimi. Në fillim të çdo viti mësimor bëhet shpërndarja e ngarkesës mësimore dhe përgatitet dhe orari mësimor. <i>Evidenca 28, 80, 88, 98, 100.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” është i organizuar në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nën ligjore në Ligjit të Arsimit të Lartë. Nga shqyrtimi i Planit mësimor vihet re se në të përfshihen 29 veprimtari formuese, ku përfshihet edhe praktika mësimore dhe detyrimet permbyllëse.[ref 99, Plani mësimor] Plani mësimor jep informacion në lidhje me: Emërtimin e cdo lënde, ndarjen e tyre sipas kategorive, percaktimin per cdo lëndë te aktiviteteteve formuese(leksione, seminare, laboratore, detyra/projekte etj), kreditet për secilën lëndë të ndara sipas aktiviteteteve formuese, Ngarkesën vjetore per orët në auditor (Viti I ka 798 orë në auditor, Viti I ka 764.5, viti III 742.5), ngarkesën semestrale dhe javore (Sem I ka 28.5 orë në auditor, sem II ka 25.5, sem III ka 27.5 orë, sem IV ka 27.5 orë, sem V ka 26.5 orë dhe sem VI ka 30.5 orë në auditor). Gjithashtu në Planin mësimor janë të percaktuara orët në auditor për secilen lëndë për të tre vitet e studimit. Në planin mësimor jepet informacion edhe për mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë që është vetëm me provim. Në syllabuset e lëndëve, jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminarëve, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj. Frekuentimi/ ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve percaktohen në rregulloren e programit të studimit, dhe risillen sipas specifikave të lëndëve edhe në syllabuset përkatëse. Vlerësimi i dijeve për lëndët semestrale apo vjetore, gjatë vitit përmbledh rubrikat si më poshtë: - pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve - dorëzimi i detyrës së kursit - pjesëmarrja dhe vlerësimi në laboratorë - provimi i ndërmjetëm/ moduli - provimi përfundimtar . <i>Evidenca 99, 100.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që	Nga takimet në Institucion dhe verifikimi i dokumentacionit rezulton se në rregulloren e PSBIM, në Statutin e UPT jepen informacionet e nevojshme për pranimin e studentëve në ciklin e parë, transferimin dhe




lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	ekuivalentimin e studimeve. Në përputhje me Rregulloren e FIMIF dhe të PSBIM në fillim të çdo viti akademik DIM miraton kriteret dhe kuotat e pranimit në PSBIM, të cilat përcaktohen sipas standardeve shtetërore dhe kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore duke parë dhe kërkesat e tregut. Pas miratimit në DIM të kriterëve dhe kuotave të pranimit ato miratohen në Dekanatin e FIMIF dhe më tej në Senatin Akademik dhe i përcillen MAS dhe bëhen publike në faqen zurtare të UPT dhe FIMIF. Kandidatët në këtë program studimi konkurojnë nëpërmjet sistemit u-albania, ku Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) koordinon procesin e aplikimit të kandidatëve. Lista me renditjen e kandidatëve afishohet në mjediset publike të njësisë kryesore, në faqen zyrtare të njësisë kryesore dhe të UPT-së. Studentët e këtij programi studimi, në kuadër të projekteve të ndryshme evropiane, mund të shkojnë dhe të realizojnë lëndë/ module në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, me të cilat UPT-ja ka marrëveshje të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve. Njohja e krediteve të realizuara gjatë procesit mësimor në institucionin pritës bëhet në përputhje me Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe të mësimdhënies në UPT. <i>Evidenca 1, 70, 71, 72.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike”, ka syllabuset e detajuara për çdo lëndë. Syllabuset janë sipas një formati të miratuar dhe unifikuar dhe në përputhje me VKM, Nr. 41, datë 24.1.2018, për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL, i ndryshuar. Në syllabuse janë dhënë informacionet e nevojshme lidhur me organizimin e lëndës në leksione/ seminare/u shtrime/ laboratore/ detyra kursi, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit, frekuentimin dhe detyrimet për zhvillimin e lëndës, mënyrën e vlerësimit, peshën që zë vlerësimi i vazhdueshëm në secilën lëndë sipas specifikës së saj . <i>Evidenca 100.</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga takimet me stafin akademik dhe drejtuesin e Departamentit, GVJ konstatoi se nga ana e stafit dhe e departamentit bëhej një punë e vazhdueshme në mënyrë periodike për përmirësimin e syllabuseve, brenda 20% të lejuar, në përputhje me ndryshimet më të fundit të fushës përkatëse. Në përfundim të çdo viti akademik koordinatori i programit të studimit mbledh propozimet e stafit akademik në lidhje me përmirësimin e elementeve të programit të studimit. Si të dhëna bazë për analizën e programit të studimit shërbejnë: të dhëna nga monitorimi i procesit mësimor, mendime të pedagogëve të përfshirë në këtë program studimi, dhe opinionet e studentëve nga sondazhet studentore të përpunuara nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Te gjitha të dhënat përfshihen në raportin e analizës vjetore të realizimit të programit të studimit. [Evidenca 43, Model analize vjetore mësimore FIMIF], [Ref 88, Rregullore e brendshme e DIM]. Në bazë të këtij informacioni KPS harton propozimet për përmirësimin e programit të studimit, të cilat diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e departamentit para fillimit të vitit të ri akademik.

	Më tej këto propozime miratohen në FIMIF dhe më tej në Senatin Akademik. [Evidenca 90, Procedura e ndryshimeve në planet mësimore] Në tre vitet e fundit akademike ka patur vetëm një ndryshim në planin mësimor të PSBIM, efektet e të cilit filluan në vitin 2023-2024. Në syllabuset e lëndëve vihet re se ka pak ndryshime të arsyeshme nga një vit në tjetrin, të kryera nga titullari i lëndës me qëllim përmirësimin, pasurimin e lëndës sipas trendit të zhvillimit të saj. <i>Evidenca 18, 43, 90, 99, 100.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Planni mësimor i këtij programi studimi është i detajuar me emërtimin e veprimtarive formuese/lëndëve të ndara në kategori, në semestra, me kreditet përkatëse të ndara sipas elementeve të cdo veprimtarie. Ngarkesa mësimore javore e lëndëve në auditor është ndërmjet 25.5-30.5 orë, gjë që është mbingarkesë për studentët.</i> <i>Programet lëndore, syllabuset, e programit të studimit janë unifikuar në nivel IAL-je. Dhe të hartuara në përputhje me formatet e miratuara nga aktet nënligjore. Në syllabuse gjithashtu, përshkruhet mënyra në kontrollin e njohurive dhe vlerësimit të dijeve, e cila ndryshon nga njëra lëndë në tjetrën në përputhje me veprimtaritë e ndryshme të parashikuara.</i> <i>Ky program studimi ka ndryshuar vetëm një herë brenda 20% të lejuar nga aktet nënligjore dhe të miratuara sipas procedurave të vendosura në UPT në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” me përvojë të gjatë ka për qëllim tu japë studentëve bazat teorike dhe praktike të inxhinierisë matematike. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. Studentët ndjehen familjarë në të paktën 2 kompani kryesore që bashkëpunojnë me FIMIF në zhvillimin e praktikave. Nga të dhënat e zyrës së karrierës dhe alumnit, dhe nga takimet në FIMIF, vihet re se shumica e studentëve, të cilët përfundojnë këtë program studimi vazhdojnë programet e ciklit të dytë Master në FIMIF, vecanërisht në programin e studimit MSH në Inxhinierinë Matematike. Të diplomuarit në PSBIM mund të vazhdojnë studimet në ciklin e dytë të studimeve edhe në degë të ndryshme inxhinierike duke bërë një numër të caktuar plotësimesh të krediteve. Studentët e PSBIM kanë mundësi të kufizuara në punësim në profesionin e diplomës së tyre, kjo jo për arsye të programit të studimit

	sipas opinionit të DIM, por edhe të zhvillimit dhe njohjes së tregut të punës. <i>Evidenca 16, 39.</i>
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Nga verifikimi i programit mësimor rezulton se, lëndët dhe modulet janë shpërndarë përgjatë 3 viteve dhe 6 semestrave në mënyrë uniforme duke respektuar ndërvarësinë formale dhe përmbajtësore të njohurive që përmban cdo lëndë. Në këtë formë mundësohet formimi gradual i studentëve. Në vitin e parë bëhen kryesisht lëndë të formimit të përgjithshëm si: Analiza Matematike, Algjebër, Statistikë, Fizikë e Përgjithshme, Kimi, informatikë. Në vitin e dytë përfshihen pothuajse vetëm lëndë karakterizuese të programit të studimit. Viti i tretë dominohet nga lëndë integruese dhe programi i studimit përmbillet me praktikën mësimore dhe Diplomën/ Provimin Final. Lëndët në planin mësimor, sasia e krediteve dhe e orëve të vëna në dispozicion për secilën disiplinë, syllabuset e tyre bëjnë të mundur që në përfundim të programit të studimit të jenë arritur objektivat formuese të këtij program studimi dhe rezultatet e të nxënit. Shpërndarja e lëndëve dhe emërtesa e tyre ngjason me modelet e zgjedhura nga DIM për këtë program në universitetet e Milanos dhe Torinos. <i>Evidenca 99, 100.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga RVB si edhe nga takimet me DIM rezulton se hartimi/organizimi i PSBIM është mbështetur në përvojën botërore në këtë fushë , përvojën dhe eksperiencën e përftuar nga bashkëpunimi ndër vite me universitetet e Athinës, Triestes, Bristolit etj, por më nga afër me Universitetin e Milanos dhe atij të Torinos. Gjithashtu DIM përfitoi edhe nga Projekti European TEMPUS “ Mathematics Education in Engineering”, TEMPUS European Project, Co.No. JEP-16119, Tirana-Vlora-Athens-Trieste, I cili kishte si objektiv “Reformimin e kurseve matematike, metodave të mësimiit dhe infrastrukturës mësimore në UPT sipas standardeve të njohura dhe të akredituara”. Në universitetet shqiptare nuk ofrohet ndonjë program studimi i ngjashëm me PSBIM. Ky program studimi është hartuar dhe organizuar ne reference me programet e ngjashme të Universiteteve të Milanos dhe triestes, ku edhe sot ato merren në reference për ndryshime të mundshme në programin e studimit. <i>[Ref 91, programe studimi të ngjashme]</i> Mbështetur në planet mësimore 2021-2022, 20022-20023, 2023-2024, për orët e zhvilluara në auditor ➤ Raporti teori praktikë, viti i parë, 2021-2022 orë gjithsej në auditor 764.5, mesatarisht është 51% teori dhe 49% praktikë (Ushtrime, laboratore dhe detyra kursi). ➤ Raporti teori praktikë, viti i dytë, 2022-2023 orë gjithsej në auditor 760.5 është 54.4% teori dhe 45.6% praktikë (Ushtrime, laboratore dhe detyra kursi). ➤ Raporti teori praktikë , viti i tretë, 2023-2024 orë gjithsej në auditor 742.5 është 43.6 % teori dhe 56.4 % praktikë (Ushtrime,

	laboratore dhe detyra kursi). GVJ vlerëson se struktura e PSBIM, lëndët, raporti teori/ praktikë për këtë program studimi është në përputhje me profilin e tij dhe i përafërt me programet e ngjashme ndërkombëtare. <i>Evidenca 91, 99.</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese e programi i studimit Bachelor në "Inxhinierinë Matematike" është në përputhje të plotë me VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik e këtij programi studimi mundësojnë arritjen e objektivave formues të tij, të shprehura në rregulloren e programit të studimit. Elementët e PSBIM dhe ngjashmëria midis këtij programi studimi dhe programeve të tjera jashtë vendit mundësojnë transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve brenda UPT dhe në IAL publike apo private brenda dhe jashtë vendit. Gjatë viteve të fundit në sajë të marrëveshjeve në kuadër të projektit Erasmus +, disa studentë të PSBIM kanë kryer mobilitete 1-2 semestra pranë disa universiteteve europiane. Në vitet e para të diplomimit në këtë program studimi, disa studentë vazhduan studimet në programet e ciklit të dytë edhe të tretë të studimeve në universitetet e huaja. <i>Vitet e fundit niveli i studentëve ka rënë dhe mobilitetet e tyre për studim dhe punësim jashtë vendit janë pakësuar.</i> <i>Evidenca 47, 72, 73, 75.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punësduke u bazuar në mendimet e studentëve, vrojtimet dhe përvojat për këtë çështje me programet e ngjashme jashtë vendit si edhe në mendimet e institucioneve publike dhe private ku studentët zhvillojnë praktikën. Përditësimi të syllabuseve i shërben edhe përditësimi i literaturës së detyruar dhe asaj ndihmëse. Cdo pedagog paraqet në DIM propozimet për ndryshime të tilla për lëndën përkatëse në analizën vjetore të lëndës dhe ato pasqyrohen në analizën vjetore mësimore të programit të studimit dhe DIM. Syllabuset e Lëndëve karakterizuese dhe në mënyrë më të moderuar ato ndërdisiplinore përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa ato të formimit të përgjithshëm ndryshimet janë fragmentale. Tekstet e këtyre lëndëve përmirësohen në periudha rreth 10 vjeçare. <i>Megjithatë konstatohet se numri i lëndëve me literaturë të 5 viteve të fundit është i pakët.</i> <i>Evidenca 92, 94.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e PSBIM garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, të shprehura këto në rregulloren e këtij program studimi. Studentët, gjatë vitit të parë, marrin njohuri të përgjithshme, të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor. Gjatë dy viteve të tjera fitojnë njohuri të thelluara në aspektet

	metodologjike dhe aplikative të matematikës në modelimin e aspekteve teknologjike dhe inxhinierike. <i>Evidenca 98.</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ky program mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në programet e ciklit të dytë në një spektër të gjerë njohurish. Studenti i PSBIM mund të vazhdojë studimet në programet e Ciklit të Dytë, Master Shkencor në Inxhinierinë Matematike dhe në 2 Mastera Profesionale që ofrohen nga FIMIF. Bazuar në teorinë e krediteve të transferueshme dhe ekuivalentimit studentët mund të vazhdojnë studimet në programet e Ciklit të Dytë, në një spektër të gjërë programesh inxhinierike që kanë kurrikulën e Bachelorit të pasur me njohuri matematike, si në Fakultetin e Inxhinierisë së Informacionit, Fakultetin e Naftës dhe Gjeomjedisit, Gjeodezisë si edhe në programet e Ciklit të Dytë ndërkombëtare që lidhen me matematikën dhe zbatimet e saj. Ka patur përvoja të tilla. Programi është në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e tregut të punës duke patur kombinim të njohurive teorike dhe aplikative të matematikës ai mund të punësohet në Institutin e Gjeoshkencës, INSTAT, institucionet bankare, administratë publike dhe disa ndërmarrje ekonomike që përdorin modele optimizimi.			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e paraqitur si edhe nga takimet në FIMIF, konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e PSBIM është në përputhje me objektivat formues të këtij program të shprehura në Rregulloren e PSBIM. Ai është në përputhje me nivelin VI sipas KKK dhe KEK. Përcaktimi i veprimtarive formuese të këtij program studimi, raporti teori-praktikë në çdo lëndë është në përputhje me profiling e programit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Kjo lehtëson mobilitetin e studentëve dhe transferimin e studimeve. Literature bazë dhe e rekomanduar sidomos në lëndët karakterizuese duhet të jetë e 5 viteve të fundit. Përmbajtja e programit garanton përfitimin e dijeve dhe kompetencave për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë në një spektër më të gjerë inxhinierik si Brenda dhe jashtë vendit si edhe punësimin e kufizuar të diplomantëve të këtij program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë	Në tre vitet e fundit akademike ka patur vetëm një ndryshim në planin mësimor të PSBIM me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit, efektet e të cilit filluan në vitin 2023-2024. Ky ndryshim ishte më pak se 20% i lejuar. Ndryshimet në planin mësimor dhe në syllabuset e tij bëhen edhe duke u bazuar në mendimin e partnerëve të

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 20

së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	DIM si Departamentet e tjera të UPT, Instituti i Gjeoshkencës, INSTAT, institucionet bankare, administrata publike dhe disa kompani që përdorin modele optimizimi, ku studentët kryesisht kryejnë praktikën mësimore. Studentët që kanë realizuar praktikën në këto institucione plotësojnë një relacion në lidhje me praktikën dhe problematikat që kanë hasur dhe kanë patur vështërsi, të cilat më pas reflektohen në përmbajtjen e programit të studimit dhe syllabuseve të tij, [Takimi me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit]. Përsa i përket të diplomuarve Zyra e Këshillimit të karrierës dhe ALUMNI në FIMIF, megjithëse është ngritur në vitin 2021, ka vendosur kontakte me shumë të diplomuar për të cilët interesohet për punësimet e tyre. Por të diplomuar në PSBIM të punësuar ka pak, pasi shumica e tyre vazhdojnë studimet e ciklit të dytë. Si studim tregu DIM bazohet në raportin Punësimi, aftësitë profesionale dhe arsimit në Shqipëri, të hartuar në kuadër të projektit Erasmus + “Avancimi i të diplomuarve dhe zhvillimi i kapaciteteve universitare në Shqipëri, GRADUA” si edhe në studimin institucional të UPT mbi tregun e profesioneve STEM. Nuk ka një studim tregu nga DIM për tregun vendas apo përfshirje faktorëve të tregut të punës në mënyrë direkte në përmirësimin e programit të studimit. <i>Evidenca 39, 75.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Disa studentë të PSBIM apo diplomantë punësohen part-time në disa ndërmarrje ndërkohë që vazhdojnë studimet Master në FIMIF apo në IAL të tjera. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI në FIMIF është ngritur në vitin 2021 dhe po ngre data bazën e studentëve të diplomuar në PSBIM dhe në programet Master në FIMIF dhe interesohet për punësimet e tyre. Por të diplomuar në PSBIM të punësuar ka pak, pasi shumica e tyre vazhdojnë studimet e ciklit të dytë. Ndërsa studentë që kanë mbaruar studimet Master në IM ka përvoja suksesi si brenda dhe jashtë vendit si në vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve doktorale apo të punësuar. Prej tyre merren sygjerrime të vlefshme për përmirësimin e programit të studimit të cilat kalojnë procedurat e miratimit. Nga biseda me studentët në FIMIF doli se për çdo kurs studimi ka një student i cili komunikon me DIM për kërkesat, mendimet e studentëve në lidhje me programin e studimit. Gjithashtu zyra e Karrierës në FIMIF organizon edhe pyetësor për studentët online për vlerësimin e lëndëve të programit të studimit sipas një procedure të përcaktuar por numri i atyre që angazhohen në plotësimin e këtyre pyetësorëve është i vogël. <i>Evidenca 3, 25, 75.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra	Profesioni i Inxhinierit matematik nuk është shumë i përhapur, kështu që nuk bën pjesë në zonën e grupimeve të mëdha si rrjete profesionale. Propozimet me interes në zhvillimin dhe përditësimin e PSBIM janë propozimet e Departamenteve apo Fakulteteve të UPT si, Departamenti i inxhinierisë së Naftës, Departamenti i Gjeodezisë, Fakulteti i teknologjisë së Informacionit

profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.				
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se FIMIF dhe DIM nxit përfshirjen e studentëve, të të diplomuarve dhe bashkëpunëtorve për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit Bachelor në "Inxhinierinë Matematike" dhe përditësimit të syllabuseve.</i> <i>Megjithë vështiresite e kuptueshme mund të bëhet dicka më mire në studimin e tregut.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimit, mësimit dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinierinë Matematike" bazohet në formën standarte të mësimit, të cilat janë të përcaktuara edhe në Rregulloren e këtij programi studimi. Transmetimi i dijeve jepet nëpërmjet, Leksioneve (1116 orë leksione), Ushtrimeve/Seminarëve (840 orë), Laboratorëve (150 orë), Detyrave të kursit (30 orë) dhe praktikave profesionale (130 orë) e punimi i diplomës 935 orë) [Evidenca 99, Plani mësues], [Ref 100, Syllabuset], [Ref 103, Suplementi i Diplomës]. Për programin mësues institucioni ka organizuar, leksione të hapura me lektorë të universiteteve të huaja në kuadër edhe të programeve ERASMUS+ <i>Evidenca 76, 99, 100, 103.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimit dhe mësimit.	Në syllabuset e lëndëve janë parashikuar forma dhe metoda alternative mësimit dhe mësimit sipas natyrës së lëndës. Në përgjithësi lëndët zhvillohen nëpërmjet leksioneve, seminarëve në raporte të caktuara dhe në lëndët karakterizuese edhe laboratore, projekt/detyra kursit dhe praktika profesionale. Nga vizita në institucion u verifikua se stafi pedagogjik i përgjigjet me seriozitet diversitetit dhe nevojave të studentëve. Pedagogët në përputhje me natyrën e programit dhe vështirësive që kanë studentët ofrojnë metoda dhe mundësi alternative (shembuj realë, etj) në mënyrë që studenti të rrisë interesin dhe dëshirën e të nxënit. FIMIF vë në dispozicion të studentëve dhe bazën e tij laboratorike e cila është e mjaftueshme dhe e pajisur mirë për secilën lëndë karakterizuese. DIM ka të punësuar edhe 1 staf ndihmës akademik, i cili ndihmon studentët dhe është në funksion të mirëmbajtjes së laboratorëve. Përdorimi i sistemeve kompjuterike është diçka normale në mbarëvajtjen e mësimit. Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët, u sollën shembuj të ofrimit nga ana e pedagogëve të metodave të ndryshme për ta bërë lëndën sa më të kuptueshme dhe të qartë për studentin. <i>Evidenca 61, 100.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Nga vizita në institucion, takimi me DIM, rezultoi se institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet përdorimit të metodave të shumëllojshme dhe fleksible për zhvillimin e mësimit me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e rezultateve të të nxënit. Institucioni ka investuar në përmirësimin e metodave dhe kushteve të mësimit. FIMIF disponon salla të bollshme dhe laboratore, të cilat janë të kompletuara me mjete bashkohore. Në kuadër të projektve Erasmus +, institucioni ka mbështetur një pjesë të stafit akademik për të kryer mobilitete të ndryshme në kuadër të trajnimit të tyre mësimit.

	Gjithashtu nga institucioni janë organizuar edhe trajnime për forma të ndryshme të organizimit të mësimdhënies online. <i>Evidenca 47, 48, 49, 50, 51.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga verifikimi i dokumentacionit (dosjeve të personelit akademik), themi se personeli akademik është kompetent për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Personeli akademik, i angazhuar pranë DIM, ofron një mësimdhënie cilësore, në të cilat ndërthuren mirë njohuritë teorike të dhëna drejtëpërdrejtë gjatë leksioneve dhe seminareve me ato praktike, përmes simulimeve dhe eksperimentimeve në laboratorë. Metodatat e mësimdhënies interactive me në qendër studentin nxisin mendimin krijues dhe krijojnë marrëdhënie të respektit të ndërsjellë. Titullarët e programeve lëndore janë staf akademik i kategorisë “Profesor”, me një eksperiencë të gjatë në këto fusha dhe janë ndër specialistët më të mirë në vend për fushat respektive. Krahas tyre, stafi akademik angazhohet në nxitjen e studentëve në mësimnxënie përmes përdorimit të platformave të edukimit <i>online</i>, si Google Classroom dhe Teams, ku studentëve ju vihen në dispozicion materiale të ndryshme mësimore, teste vetëvlerësuese, detyra kursi etj. <i>Evidenca 79, 80, 100.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga vizita në institucion dhe bisedat me stafin akademik të DIM që është përgjegjës për PSBIM, rezultoj se format dhe metodat e mësimdhënies janë në vlerësim të vazhdueshëm nga vetë stafi akademik dhe departamenti. Koordinator i programit të studimit është në komunikim të vazhdueshëm me pedagogët tutorë dhe studentët për të tërhequr mendimin e tyre për metodat e mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit. Gjithashtu NJSCB organizon në çdo fund semestri pyetësor me studentët për çdo anëtar të personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm si edhe për çdo lëndë ku përthithet mendimi i studentëve në lidhje me metodat e mësimdhënies. Sygjerimet e studentëve ndjekin procedurat e përcaktuara për miratim në ndryshime të ndryshme në përmbajtjen e programit të studimit. <i>Evidenca 25.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	UPT ka ngritur si struktura si, Njësia Qëndrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC) dhe Drejtoria e Kurrikulës për promovimin dhe përmirësimin e mësimdhënies. Edhe FIMIF ka ngritur në 2021 Njësinë e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ALUMNI dhe karrierës e cila bashkërendon punën me NJQSC në UPT. Institucioni mbështet trajnimin shkencor të personelit akademik nëpërmjet pjesmarrjes në konferenca shkencore, botimeve shkencore dhe pjesmarrjes në projekte. Ai mbështet trajnimin didaktik të personelit akademik vetëm nëpërmjet mobiliteteve në kuadër të projekteve Erasmus+, organizimit të leksioneve të hapura dhe sigurimit të mjeteve të nevojshme për zhvillimin e metodave të reja inovative në mësimdhënie. <i>Evidenca 1, 9, 27, 28.</i>

Konkluzione	GVJ konstaton se UPT dhe FIMIF garanton procesin e të nxënësve nëpërmjet formave dhe metodave të ndryshme të mësimdhënies duke ju përgjigjur nevojave të studentëve. Institucioni ka strukturat e duhura për sigurimin e një mësimdhënie productive. Trajnimi i stafit akademik kryhet vetëm nëpërmjet mobiliteteve të trajnimit në kuadër të projektit Erasmus+ dhe oreve të hapura të organizuara nga DIM.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të paraqitura në rregulloren e IAL, rregulloren e FIMIF dhe në Rregulloren e PSBIM. Në këto rregullore përcaktohen detyrimet mbi frekuentimin e studentëve i cili është i ndryshëm sipas elementeve të lëndës. Gjithashtu në to përcaktohen edhe komponentët e vlerësimit të studentëve. Të gjitha rregulloret janë të publikuara në faqen zyrtare të UPT dhe FIMIF. Përveç kësaj studentët njihen me to edhe në fillim të studimeve. <i>Evidenca 12, 28, 98.</i>												
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	Nga vizita në institucion rezultoi se në javën e parë të çdo viti akademik student informohet në lidhje me metodologjinë e testimit dhe vlerësimin e njohurive dhe dijeve. Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm notave të: provim i ndërmjetëm, vlerësim i projektit/detyrë kursi, vlerësimi i punëve të laboratorit, provimi përfundimtar. Pësia e secilës mënyrë vlerësimi është më e detajuar në syllabusin e secilës lëndë. Në planin mësimor vihet re se të gjitha lëndët vlerësohen me provim përfundimtar (27 të tillë). Provimi i ndërmjetëm zhvillohet nga pedagogu titullar i lëndës, i cili përcakton vetë kohën dhe pësien e tij. Një shembull më i përgjithshëm marrë nga një Syllabus është në tabelën e mëposhtme. <table border="1"> <tr> <td>Pjesëmarrje dhe aktivizimi në orët e seminareve dhe ushtrimeve</td><td>5 %</td></tr> <tr> <td>Dorëzim i detyrës së kursit</td><td>5 %</td></tr> <tr> <td>Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë</td><td>10 %</td></tr> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm/Moduli</td><td>20 %</td></tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td><td>60 %</td></tr> <tr> <td>Gjithsej</td><td>100 %</td></tr> </table> Cdo pedagog, titullar lënde, në fillim të lëndës informojnë studentët për mënyrën e vlerësimit të saj. <i>Evidenca 99, 100.</i>	Pjesëmarrje dhe aktivizimi në orët e seminareve dhe ushtrimeve	5 %	Dorëzim i detyrës së kursit	5 %	Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10 %	Provimi i ndërmjetëm/Moduli	20 %	Provimi përfundimtar	60 %	Gjithsej	100 %
Pjesëmarrje dhe aktivizimi në orët e seminareve dhe ushtrimeve	5 %												
Dorëzim i detyrës së kursit	5 %												
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10 %												
Provimi i ndërmjetëm/Moduli	20 %												
Provimi përfundimtar	60 %												
Gjithsej	100 %												

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në çdo rast nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm të pedagogut me studentin nëpërmjet zhvillimit të testeve me shkrim dhe me gojë sipas specifikave të përcaktuara në syllabuset e lëndëve, laboratoreve, detyrave të kursit apo prezantimeve të tyre, punimeve dhe prezantimeve të diplomës. Të gjitha këto forma i japin mundësi studentëve të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.			
Kriteri 4. Njësia bazë/ Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	UPT në nivel institucional ka ngritur qendra përkatëse të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, ku përfshihen pedagogue dhe studentë. Qendra të tilla janë NJQSC, Drejtoria e Kurrikulës ne UPT dhe DSBC, ALUMNI dhe Karrierës në FIMIF, të cilat monitorojnë cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet analizës së secilës lënde që bën pedagogu titular, pyetësorit për studentët që zhvillohet në fund të cdo semestri. Nga përpunimi i të dhënave të pyetësorve hartohet raporti mbi këto gjetje i cili punohet në cdo Departament sipas programeve të studimit. DIM mbi bazën e analizave individuale të pedagogëve, analizës që kryen KPS në bashkëpunim me studentët realizojnë analizën mësimore vjetore. Raporti analitik i bëhet me dije cdo anëtar i DIM dhe shërben si bazë për përmirësim te formave të mësimdhënies. <i>Evidenca 25, 43, 92, 94.</i>			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues të programit të studimit. Çdo vit akademik me anë të një fondi të vecantë cdo pedagog këkon shtimin e literaturës në funksion të aktiviteteve didaktike dhe shkencore të fushës përkatëse duke pasuruar bibliotekën e DIM dhe FIMIF. Detyrat e kursit, projektet janë një stimuli i punës në grup të studentëve dhe inkurajojnë autonominë e tyre. Gjatë punës për këto detyra studentët mbështeten dhe orientohen nga pedagogu i lëndës si nëpërmjet komunikimit të drejtëpërdrejtë gjatë orëve mësimore dhe orëve të konsultimeve të cilat janë parashikuar dhe janë njoftuar studentët qe në fillim të lëndës edhe nëpërmjet komunikimit elektronik përmes postës elektronike zyrtare personale me të cilën studentët pajisen sapo regjistrohen ne FIMIF emër.mbiemër@fimif.edu.al. Këto forma komunikimi dhe metoda mësimdhënie ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. <i>Evidenca 34.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UPT ka të hartuara rregullore dhe procedura të posacme testimi dhe vlerësimi për studentët dhe garanton zbatimin e tyre. Megjithatë mendojmë se duhet një hapësirë më e madhe për vlerësimin e vazhduar duke ulur numrin e provimeve përfundimtare dhe shlyerjen e disa lëndëve sidomos ato me karakter të theksuar praktik me vlerësime të vazhdueshme. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë autonominë e studentëve duke u mbështetur dhe udhëzuar nga pedagogët përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi e vlerësimi të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në UPT realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Kjo është e shprehur në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, neni 33. Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret një sistem pikëzimi mbi bazën e të cilit bëhet vlerësimi me notë sipas sistemit shqiptar të vlerësimit (nota nga 1-10). Provimet përfundimtare të lëndëve zhvillohen brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik. Datat e tyre propozohen nga sekretaritë mësimore me zëvendësdekanin për anën mësimore, në bashkëpunim me departamentet, miratohen nga dekani dhe shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit. Provimet zhvillohen në tre sesione: – Sezoni i provimeve të dimrit, i cili zhvillohet pas përfundimit të semestrit të parë; – Sezoni i provimeve të verës, i cili zhvillohet pas përfundimit të semestrit të dytë; – Sezoni i provimeve të vjeshtës, i cili zhvillohet në Shtator. Vlerësimet për komponentët e vlerësimit përfundimtar si, provimet e ndërmjetme, labororet, detyrat e kursit etj nuk janë të planifikuara nga Departamenti apo Fakulteti. Ato zhvillohen në kohën dhe sasinë e lëndës së përfshirë në to nga Pedagogu i secilës lëndë. Edhe frekuentimi mbahet nga pedagogu përkatës që i përcjell sekretarisë vetëm personat që nuk mund të hyjnë në provimin përfundimtar. Detajet e formave të vlerësimit për secilën disiplinë jepen të detajuara në syllabuset e lëndëve të cilat miratohen në fillim të çdo viti akademik nga drejtuesi i njësisë bazë. Provimi përfundimtar i lëndës zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar sipas përcaktimit nga pedagogu në syllabusin e lëndës. Studenti ka të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar të lëndës kur ka shlyer detyrimet e përcaktuara në rregullore. <i>Evidenca 12, 77.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga vizita në institucion rezultoi se format e testimit janë ato klasike. Kontrolli i dijes bëhet me shkrim, me gojë ose kombinimi të dyjave sipas lëndëve përkatëse. Tezat e provimeve përfundimtare sekretohen, të cilat pas korigjimit nga pedagogu/ët e lëndës, c'sekretohen në Departament. Aktualisht në UPT nuk ka një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve. Në platformën elektronike bit-albania, hidhen rezultatet e vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar duke informuar studentët në kohë reale për rezultatet e tyre dhe rritur transparencën <i>Evidenca 60.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në	Nga vizita në institucion rezultoi se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet nga komisione me të paktën 2 anëtarë të cilët janë prezentë në

përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	sallë gjatë zhvillimit të provimit. Ata janë përgjegjës për zbatimin e rregullave të miratuara për procesin e zhvillimit të provimit dhe për çdo vendimarrje që lidhet me mbarrëvajtjen e këtij procesi. Për çdo vendimarrje të kësaj natyre ata venë në dijeni menjëherë përgjegjësin e departamentit. Anëtarët e komisionit të provimit janë lektori i lëndës dhe asistent – lektorit të lëndës ose pedagog i grupit përkatës. Në rastet kur nuk ka një të tillë, departamenti vendos një pedagog tjetër me profil të afërt me lëndën e provimit. <i>Evidenca 12.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga studentet gjatë takimit që u realizua me atë theksua se në të gjitha format e vlerësimit të vazhdueshëm stafi akademik i shoqëron vlerësimet me komente, këshilla dhe sqarime në lidhje me lëndën mësimore për të ndihmuar studentët të përmirësohen. Në provimin përfundimtar të lëndës studentët kanë të drejtë në bazë të rregulloreve në fuqi të kërkojnë sqarime për vlerësimin e bërë duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezen e zgjidhur si edhe të ankimojnë vlerësimin.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/ nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i listave të notave u la të kuptohej që pedagogët përpunon të shmangin në maksimum fenomenin e kopjimit në provime (duke realizuar teza të ndryshme dhe ndarë studentët në grupe të ndryshme, duke rritur distancën e sigurisë midis studentëve në provim, etj). Studenti, i cili në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi. Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, për të proceduar tej në përputhje me Kodin e Etikës së UPT-së. Rastet e dyshuara për kopje trajtohen në mënyrë të vecantë sipas rastit me qëllimin e vertetimit të kopjimit dhe vlerësimin real të studentit. Shkeljet e faktura trajtohen nëpërmjet një komisioni të pavarur disiplinor në Këshillin e Etikës dhe ndëshkohen në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e UPT. Rregullat për shmangjen e kopjimit në provim apo në testime të tjera janë të shprehura edhe në Rregulloren e programit të studimit. <i>Evidenca 2.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i provimeve të korrigjuara u verifikua se: Korrigjimi i provimit për lëndën mësimore bëhet nga pedagogu titullar. Korrigjimi mundësohet brenda 5 ditë pune nga dita e përfundimit të provimit. Komisioni vë në dijeni studentin për rezultatin e vlerësimit para plotësimit të dokumentacionit përkatës. <i>Evidenca 12.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në bazë të Statutit, Rregulloreve në UPT si dhe nga vizita në institucion u verifikua se, studenti njihet me vlerësimin para plotësimit të dokumentacionit përfundimtar. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara me tezen e zgjidhur. Nëse studenti nuk bie dakord, apo nëse ndaj tij janë shkelur procedurat e marrjes në provim, ai ka të drejtë të ankimojë provimin me anë të një kërkesë me shkrim në sekretarinë e Dekanit Brenda 3 ditëve nga dalja e rezultatit.

Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Dekani shqyrton kërkesën dhe mund të thërrasë për sqarim përgjegjësin e departamentit, komisionin e provimit dhe studentin. Më tej Dekani merr vendim të formës së prerë Brenda 3 ditëve pune. Nëse ankesa e studentit është e drejtë dekani shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit dhe vendos që student të rivlerësohet. Procedura është e mire përcaktuar në rregulloren e FIMIF dhe në rregulloren e programit të studimit. Procedura e ankimimit arshivohet në arshivë. <i>Evidenca 12, 28.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritë duke shmangur mundësitë e kopjimit, për çdo student. Procedurat e provimit janë të paraqitura në statutin dhe rregulloret e UPT duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent. Komisioni I provimit bën ballafaqimin me studentët duke argumentuar rezultatin e vlerësimit. Studentë që nuk janë dakord me vlerësimin kanë të drejtën e ankimimit te Dekani, i cili pasi e shqyrton merr vlerësim të formës së prerë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinierinë Matematike" është i strukturuar në tre vite akademike. Bazuar në strukturën e programit mësimor mund të themi se: Gjatë vitit të parë akademik, programi ka si synimin të ofrojë njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor. Ndërkohë që gjatë 2 viteve të tjera akademike, nëpërmjet lëndëve karakterizuese ai pajiset me njohuritë tipike të inxhinierit dhe të matematikës së aplikuar. Studenti gjithashtu aftësohet në përdorimin e teknologjisë kompjuterike dhe softveve matematike. Nëpërmjet praktikave mësimore, punëve laboratorike, detyrave të kursit programi mësimor zhvillon aftësitë profesionale të studentëve.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit Bachelor në "Inxhinierinë Matematike" është program i formimit inxhinierik. Programi mundëson marrjen e njohurive në fushën e teknologjisë së informacionit, por në përputhje me profilin përkatës. Planet mësimore dhe programet lëndore garantojnë përveç zhvillimit të aftësive e kompetencave në fushën përdorimit të matematikës në zgjidhjen e problematikave inxhinierike edhe aftësimin e studentëve në fushën e menaxhimit ekonomik, të komunikimit dhe bashkëveprimit duke përfshirë edhe gjuhët e huaja. Në këtë program studimi, studentët mund të zgjedhin të zhvillojnë një nga pesë gjuhët zyrtare të BE. Qëllimi kryesor është të thellojnë njohuritë në gjuhën e huaj, por edhe pasurojnë fjalorin me terminologjinë teknike të profilit përkatës që të kuptojë tregun e punës dhe të jetë komunikues e të

	punojë në grup. Evidenca 99, 100.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Përmbajtja e programit të studimit është bashkëkohore, ajo përmban lëndët bazë për zhvillimin e mëtejshëm shkencor, lëndët e shumëllojshme karakterizuese të fushës, të cilat formojnë një inxhinier me kompetenca në metodologjinë moderne të Matematikës së Aplikuar. Pedagogët titullar lëndësh në programin e studimit në përfundim të çdo viti akademik verifikojnë kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në përfundim të lëndës mësimore të cilat i paraqesin në analizën individuale vjetore. [Evidenca 94, Model analize për lënde, pedagogu]. Departamenti mbështetur mbi analizën individuale të pedagogut, në analizën e koordinatorit analizon treguesit cilësor të kompetencave të fituara nga studentët dhe përcakton përmirësimet e duhura, për të cilat njoftohen studentët. Nga vizita në institucion u verifikua se: në përfundim të çdo lënde stafi akademik përgjegjës orienton studentët drejt pikave dhe çështjeve më të rëndësishme. Këto pika mund të jenë subjekt i provimit si dhe janë elementë të rëndësishëm të cilët gjejnë përdorim në aplikime reale industriale. Gjithashtu, me kërkesë të studentëve pedagogu i lëndës zhvillon seanca konsultimesh përpara zhvillimit të provimit. Evidenca 12, 92.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bazuar në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në "Inxhinierinë Matematike" mund të themi se Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të paraqitura në çdo syllabus. Kurrikula është hartuar në mënyrë të tillë që tu japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktika profesionale. Temat laboratorike janë në përputhje me temat e leksioneve dhe seminarëve. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për praktikën profesionale. Nga vizita në institucion u panë laboratorët në funksion të PSBIM. Laboratorët ishin të rinj ose rikonstruktuar dhe të pajisur me mjete laboratorike bazë dhe pajisje specifike profesionale. Nga biseda me DIM dhe studentët u verifikua se disa tema dhe detyra kursi jepen në formë të tillë që të stimulojnë punën në grup. Sipas pedagogëve përgjegjës qëllimi kryesor është të nxitin punën në grup aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve si dhe diskutimin e tyre. Kjo dëshmohej edhe në aktivizimin e studentëve në organizimin e seminareve dhe ëorkshope dhe organizimin e orëve të hapura. Nga takimi me DIM u verifikua se personeli akademik kombinon format e mësimdhënies me institucionet partnere për të mundësuar dhe rritur lëvizshmërinë e studentëve. Në vitet e fundit në sajë të bashkëpunimeve me disa universitete në kuadër të projektit Gradua dhe marrëveshjes Erasmus+, një numër pedagogesh edhe studentësh kanë realizuar mobilitete dhe trajnime në disa universitete të huaja. Evidenca 40, 47, 61, 76.
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe	Nga vizita në institucion u verifikua se, Dim dhe Zv. Dekani për kërkimin shkencor janë të angazhuar për realizimin e orëve të hapura, ku janë ftuar profesorë të huaj të njohur të fushës nga disa Universitete të njohura si Orleans-france, politecnico di Torino, ISCTE-IUL

teknologjisë brenda/ jashtë strukturës së programit të studimit.	Instituto-universitario de Lisboa, etj. <i>Evidenca 40.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga vizita në institucion konstaton se institucioni ngre struktura të posaçme të cilat promovojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e cila realizohet në bazë kompetencash të shprehura në syllabuset e cdo lënde. Personeli akademik mbështet punën në grup duke lejuar zhvillimin e ideve novative. Infrastruktura laboratorike rrit autonominë e studentëve dhe i aftëson ata nga ana profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e PSBIM, në përputhje me Statutin, rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, është përcaktuar që në përfundim të programit të studimit studentët kanë të drejtë të diplomohen. Diplomimi kryhet ose me punim diplome ose me provim final. Para diplomimit studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet financiare dhe materiale me FIMIF dhe UPT. Studentët që shlyejnë provimet e të tre viteve të studimit me nje notë mesatare të përcaktuar nga DIM mund të diplomohen me punim diplome. <i>Evidenca 98.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	DIM ka hartuar dhe njeh studentët diplomantë me Udhëzuesin për punimin e diplomës Bachelor dhe përgatitjen e provimit final. Studentët që në fillim të vitit të tretë informohen në lidhje me detyrimet përmbyllëse. Studentët që do bëjnë diplomë në fund të semestrit të parë të vitit të tretë, pasi zgjedhin udhëheqësin në varësi të fushave të preferencës, dakortësohen me të për temën e diplomës. Miratimi i temës së diplomës dhe udhëheqësit përkatës bëhet nga përgjegjësi i departamentit. Udhëheqësi i diplomës harton planin e punës duke vendosur edhe afate të përafërta për realizimin e detyrave Për studentët që diplomohen me provim final jepen udhëzime si në udhëzuesin për punimin e diplomës dhe provimit final ashtu edhe nga stafi akademik. DIM ka përgatitur programin për provimin final duke përfshirë njohuri nga të gjitha lëndët sipas peshës specifike të tyre. Programi i provimit final, fushat e temave të diplomës dhe rregullorja e programit të studimit janë të aksesueshme edhe online në faqen e FIMIF. <i>Evidenca 101.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final	Ne Udhëzuesin për punimin e diplomës dhe përgatitjen e provimit final është dhënë edhe program i provimit final i cili bazohet në njohuritë e

bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	dhëna gjatë gjithë viteve akademike duke përfshirë të gjitha lëndët sipas peshës specifike të tyre. Studentët njihen me programin e provimit final si edhe me procedurat e tij përveç rregullores së programit të studimit dhe udhëzuesit përkatës që janë të aksesueshem online në faqen e UPT dhe FIMIF, por edhe nga pedagogu tutor i vitit të tretë. Komisioni i provimit final që mbulojnë kryesisht lëndët që janë në programin e provimit final propozohen nga DIM dhe miratohen nga Dekani i FIMIF. DIM për t'ju ardhur në ndihmë studentëve të vitit të tretë për provimin final organizon konsultime me ta për tematika të ndryshme të programit të provimit final sipas nje grafiku të miratuar prej tij e të shpallur në mjediset publike. Data e provimit përfundimtar caktohet 2 javë pas sezonit të provimeve. Studentët iu bëhet e ditur data dhe informacioni i nevojshëm. Ata mund ti aksesojnë lehtësisht në faqen e internetit të FIMIF.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	DIM në fillim të cdo viti akademik shpall listën e pedagogëve udhëheqes për diplomat e PSBIM me fushat përkatëse. Studentët pasi zgjedhin udhëheqësin në varësi të fushave të preferencës, dakortësohen me të për temën e diplomës. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin për përzgjedhjen e literaturës përkatëse dhe e orientojnë atë praktikisht. DIM vë në dispozicion të studenteve bibliotekën e departamentit e cila pajiset gjithmonë me literature bashkohore. Gjithashtu në funksion të tyre janë edhe labororet e informatikës kryesisht por edhe labororët e tjerë. Udhëheqësi i diplomës e asiston studentin edhe në përpunimin e të dhënave dhe në punimin e diplomës sipas modelit të paraqitur në udhëzuesin për punimin e diplomës. Studenti kalon kontrollet për ecurinë e punimit të diplomës dhe fiton të drejtën për ta mbrojtur atë pasi e ka përfunduar të gjithë punimin të miratuar nga udhëheqësi. <i>Evidenca 62, 63, 82, 101.</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga bisedat me studentët dhe stafin akademik të DIM konstatojmë se DIM asiston studentët për kryerjen e temave të diplomës edhe kur ato kanë në përmbajtje përpunim të dhënash të marra nga institucione që DIM bashkëpunon në kryerjen e praktikave mësimore si IGJEM. INSTAT, bankat apo shoqëri sigurimesh etj. Gjithashtu ai vë në dispozicion të tyre infrastrukturën laboratorike të FIMIF. Në labororët kompjuterik janë në dispozicion të studentëve edhe softet si MATLAB=Academic staff version, R-studio, Q 315 etj.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se studentit, në përfundim të provimit përfundimtar, është vlerësuar me notë. Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Nota e vlerësimit është në përputhje me sistemin shqiptar të vlerësimit. Nota maksimale është 10 dhe ajo minimale e kalimit është 5. Nota i komunikohet studentit dhe vendoset në proce verbal. <i>Evidenca 83.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga	Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se studentët të cilët përfundojnë ciklin e studimeve trevjeçare pajisjen me diplomë në programin e studimit Bachelor në "Inxhinierinë Matematike" dhe me suplementin e saj. Formatit i diplomës dhe i suplementit është i miratuar

ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	nga MAS. Studentët e interesuar, me kërkesë të tyre, ju vihet në dispozicion një kopje e plotë e programit mësimor dhe syllabuset e lëndëve të zhvilluara, të firmosura nga titullari i Institucionit. Kjo kopje zyrtare i dorëzohet kërkuarit jo më vonë se 10 ditë nga kërkesa. <i>Evidenca 85, 102, 103.</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në sekretarinë mësimore të FIMIF sii dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, Të gjitha dokumentat e studentëve gjatë ciklit të studimeve të tyre arkivohen sipas kërkesave ligjore. Edhe pas diplomimit dokumentat e studentëve arkivohen. Kohë pas kohe studentët kërkojnë dokumente specifike për të provuar statusin e tyre studentor për arsye të ndryshme. Sipas kërkesave të tyre, ekzistojnë lloje të ndryshme të dokumenteve të regjistruara, të lëshuara për t'u përdorur nga institucione të tjera. <i>Evidenca 85.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregullore dhe udhëzues të qartë për procedurat dhe përmbajtjen e detyrimeve përmbyllese të studentit në këtë program studimi. Në përfundim të studimeve institucioni e pajis studentin me Diplomën përkatëse dhe syplementin e diplomës te miratuar në MAS.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/ moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin të gjitha kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit akademik. Çdo anëtar i personelit akademik ka të paktën një gradë master ose doktoraturë në fushën përkatëse, duke siguruar kështu drejtimin e duhur të programit dhe mbulimin e lëndëve/ moduleve të tij. Përveç kësaj, ata kanë përvojë të dokumentuar në kërkime shkencore ose eksperiencë praktike që përputhet me natyrën dhe veçoritë specifike të moduleve të programit. Kjo garanton cilësinë e mësimdhënies dhe mbështet zhvillimin e materialeve mësimore të cilësisë së lartë, duke përmbushur nevojat dhe standardet akademike të institucionit. Për vitin akademik 2021- 2022 stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është: 29 PAE (3 Prof, 5 Prof As, 19 Dr, 2 Msc) dhe 4 PAK (2 Prof As, 1 Dr, 1 Msc); Për vitin akademik 2022- 2023 stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është: 31 PAE (2 Prof, 9 Prof As, 16 Dr, 4 Msc) dhe 3 PAK (2 Prof As, 1 Msc); Për vitin akademik 2023- 2024 stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është: 31 PAE (2 Prof, 13 Prof As, 12 Dr, 4 Msc) dhe 3 PAK (2 Prof As, 1 Msc); <i>Evidenca 27,79,80, Tabela 7 e aneksve</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Ngarkesa mësimore e personelit akademik është e përcaktuar dhe e respektuar sipas normave ligjore, duke siguruar një menaxhim efektiv të orëve mësimore dhe të angazhimit akademik. Pothuajse e gjithë ngarkesa mbulohet nga stafi efektiv dhe vetem 3 lëndë nga stafi me kontratë, duke tejkaluar në këtë mënyrë edhe kërkesën ligjore. Për vitin akademik 2023- 2023 ngarkesa është 93% nga personeli akademik efektiv (PAE) dhe 7% nga personeli akademik me kontratë (PAK). <i>Evidenca 42. Tabela 12 e aneksve</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit,	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga vizita e kryer e takimi me përfaqësues të burimeve njerëzore, institucioni siguron që të gjithë anëtarët e personelit akademik kanë kontrata të qëndrueshme dhe të mbuluara me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë periudhën e akreditimit. Pam konkretisht edhe modele të tjera kontratash si për Personelin efektiv ashtu edhe për personelin me kontratë. Dosjet

duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	ishin të plota me të gjitha dokumentacionet e kërkuara dhe nuk kishte lëvizje të stafit gjatë viteve në të cilat programi akreditohej. <i>Evidenca 28.</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	U shqyrtuan dy praktika rekrutimi të stafit akademik për programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Matematike. Në to ishin paraqitur kriteret të përgjithshme, si niveli i kualifikimit i kërkuar, fusha e arsimimit, eksperiencia në punë, kualifikimi shkencor. Në kërkesën e departamentit shprehet edhe fusha për të cilën kërkohet rekrutimi i stafit, duke listuar lëndët në të cilat do të angazhohet në mësimdhënie. Në dy praktikatat e shqyrtuara, personeli akademik i rekrutuar kishte ekspertizën në përputhje me kërkesat specifike të shpallura. Komisioni i vlerësimit bën renditjen e kandidatëve që plotësojnë më mirë kërkesat për vendin e punës dhe ja përcjell dekanit të fakultetit.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga verifikimi rezulton se institucioni ka të angazhuar personel akademik ndihmës sipas natyrës specifike të programit të studimit. Në të gjithë laboratorët e UPT janë të angazhuar staf ndihmës akademik të cilët kontribuojnë në funksion të zhvillimit të seancave laboratorike, në mirëmbajtjen e laboratoreve si dhe janë në ndihmë të personelit akademik. <i>Evidenca 61.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UPT në strukturën e vet organizative të tij ka miraturar Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Këto të dhëna, që ruhen nga Drejtoria e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe në arkivën e çdo njësie kryesore, nga specialistja e personelit dhe arkivit, që përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. Departamenti përgjegjës për këtë program studimi mirëmban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie, ku përfshihen lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që aktivizohen çdo vit, lëndët/modulet që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për çdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale. <i>Evidenca 13, 28, 81.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe	Nga vizita në institucion rezuloi se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, me kompani të cilat operojnë në fusha të ndryshme të inxhinierisë. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë si qëllim njohjen e tregut të punës dhe realizimin e praktikave mësimore. Nga vizita në institucion dhe verifikimi i dokumentacionit rezultoi se praktika mësimore kryhet pranë kompanisë dhe nën drejtimin e një pedagogu. Pedagogu përgjegjës caktohet nga departamenti. Një

mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	pedagog ka në mbikqyrje një nr të vogël studentësh, e indikuar kjo edhe nga numri i ulët i regjistrimeve në këtë program studimi. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve për praktikat mësimore, parashikohet përcaktimi nga ana e institucionit pritës i një udhëheqësi të praktikës, i cili të kontrollojë dhe të informojë mbi mbarëvajtjen e saj. Detyrimi përmbyllës për këtë program studimi është provimi përfundimtar <i>Evidenca 6, 39.</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbylljen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Personeli mbikqyrës është i angazhuar dhe mbështet studentët në përmbylljen e detyrimeve të praktikës profesionale, duke marrë pjesë në procesin e vlerësimit dhe duke ofruar udhëzime të rëndësishme për përmirësimin e performancës së tyre. <i>Evidenca 6, 39.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë siguron që personeli akademik dhe ndihmës akademik të jetë i kualifikuar dhe të përmbyllë të gjitha kërkesat ligjore dhe akademike për të mbuluar programet e studimit. Këto masa sigurojnë një mjedis mësimdhënës të cilësisë së lartë dhe mbështetje të plotë për studentët gjatë gjithë ciklit të tyre akademik.</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në institucion, si edhe nga dokumentat e vëna në dispozicion nga grupi i vlerësimit të brendshëm, vërehet se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, duke marrë parasysh numrin e studentëve dhe grupeve mësimore. Këto mjedise janë të pajisura dhe të dizajnuara në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. <i>Evidenca 33.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së	Sallat e leksioneve, laboratorët, dhe hapësirat e tjera akademike janë të mjaftueshme për të akomoduar të gjithë studentët dhe për të mbështetur mësimdhënien efektive. Infrastruktura përfshin pajisje moderne dhe teknologji të nevojshme për zhvillimin e moduleve, duke siguruar një

informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	mjedis të përshtatshëm për mësim dhe kërkim shkencor. <i>Evidenca 33.</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Laboratorët dhe mjediset e tjera specifike për programin e studimit janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për të plotësuar kërkesat e moduleve. Këto ambiente mbështesin aftësimin teorik dhe praktik të studentëve dhe përbushin objektivat formues të programit të studimit. Pajisjet dhe teknologjitë në këto mjedise janë moderne dhe të mirëmbajtura, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe efektiv për të gjitha aktivitetet mësimore dhe kërkimore. Kjo siguron që studentët të kenë qasje në burimet e nevojshme për të zhvilluar kompetencat e tyre në përputhje me standardet akademike dhe profesionale të programit. <i>Evidenca 105, tabela 17.</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në institucion rezulton se Institucioni i arsimit të lartë siguron të paktën dy laborator të teknologjisë së informacionit, të cilët janë të pajisur me programe profesionale që përputhen me natyrën e programit të studimit. Laboratorët janë të aksesueshëm për të gjithë studentët dhe janë të pajisur me kompjuterë të avancuar dhe softëra të specializuar që mbështet mësimdhënien dhe zhvillimin e aftësive praktike në teknologjinë e informacionit. Këto pajisje dhe këto programe janë të përditësuara rregullisht për të mbajtur hapin me zhvillimet më të fundit në fushë, duke garantuar që studentët marrin një edukim të cilësisë së lartë dhe të përputhshëm me kërkesat e tregut të punës.			
Konkluzione	<i>Institucioni ka krijuar një mjedis të përshtatshëm për edukimin e studentëve, duke garantuar burime të kualifikuara njerëzore dhe infrastruktura moderne që mbështesin zhvillimin akademik dhe profesional të tyre.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse për studentët është e disponueshme në gjuhën shqipe, duke siguruar që studentët të kenë qasje në burimet e nevojshme për të përbushur kërkesat akademike. <i>Evidenca 62, 63, 100, https://ulibrary.rash.al/</i>



Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Njësia përgjegjëse raporton rregullisht përditësimet e literaturës, duke përfshirë botime të viteve të fundit, për të siguruar që burimet e përdorura janë të përditësuara dhe relevante. <i>Evidenca 28, 63.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka mësimore është e hapur dhe e aksesueshme për të gjithë studentët, duke siguruar një përdorim të barabartë dhe të drejtë të burimeve të saj. <i>Evidenca 62.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka një fond të mjaftueshëm fizik që përfshin tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse dhe revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaja, të cilat janë të përshtatshme për të mbuluar të gjitha modulet dhe veprimtaritë mësimore të programit të studimit. <i>Evidenca 63, 64.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Studentëve u ofrohet akses i barabartë dhe pa pagesë në bibliotekat online, duke siguruar që të gjithë studentët të kenë qasje në burimet digjitale të nevojshme për studimet e tyre. <i>Evidenca 62, Cobiss</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita në institucion grupi i vlerësimit të jashtëm vërejtë se biblioteka është e pajisur me teknologji dhe pajisje kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët, duke përfshirë programe kompjuterike dhe akses në internet.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Orari i shërbimit të bibliotekës është fleksibël dhe i përshtatshëm me oraret e mësimi, duke u hapur edhe përtej orareve të mësimi për të përmbushur nevojat e studentëve dhe kapacitetin e saj.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësiti përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën	Biblioteka dhe njësiti përgjegjëse ndjekin dhe raportojnë rregullisht për cilësinë dhe përditësimin e fondit të bibliotekës, duke siguruar që të gjitha burimet janë efektivisht të shfrytëzuara nga studentët dhe personeli akademik.

e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<i>Evidenca 62.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë garanton që programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar, dhe ofron mjediset mbështetëse për mësimnxënien, duke përfshirë bibliotekën dhe burimet digjitale. Këto masa sigurojnë që studentët kanë qasje të barabartë dhe të drejtë në të gjitha burimet e nevojshme për përmbushjen e kërkesave akademike të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni ka një sistem të brendshëm menaxhimi që lejon administrimin e informacionit të studentëve që nga regjistrimi deri në diplomim. Ky sistem përfshin të dhënat personale, rezultatet akademike, aktivitetet mësimore dhe pjesëmarrjen në programin e studimit. Për më tepër, sistemi është i projektuar për të siguruar që informacioni të jetë i plotë, i saktë dhe i përditësuar në çdo kohë. <i>Evidenca 59, 60.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i menaxhimit përfshin funksionalitete për administrimin e informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik dhe administrativ, duke përfshirë kualifikimet, ngarkesën mësimore, publikimet shkencore, dhe aktivitetet e ndryshme akademike. Për më tepër, sistemi përfshin edhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit, duke mundësuar një administrim të plotë dhe të integruar të të gjitha palëve të përfshira. <i>Evidenca 59, 62.</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi siguron që të gjithë përdoruesit, duke përfshirë studentët dhe personelin, kanë akses të dedikuar dhe të personalizuar në informacione dhe dokumente të rëndësishme. Ky akses është i menaxhuar në mënyrë që të sigurohet privatësia dhe siguria e të dhënave, duke mundësuar vetëm atyre që kanë nevojë për qasje të kenë mundësi të përdorin informacione specifike. <i>Evidenca 59.</i>

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit përfshin platforma dhe module të integruara që lejojnë komunikim interaktiv midis personelit akademik dhe studentëve. Këto mundësi përfshijnë forume diskutimi, mësim online, mesazhe direkte dhe feedback në kohë reale, duke siguruar një mjedis të ndërlidhur dhe bashkëpunues për të gjithë përdoruesit. <i>Evidenca 50, 59.</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit siguron monitorim në kohë reale të të gjitha aktiviteteve akademike dhe administrative. Ky monitorim lejon organet dhe autoritetet drejtuese të kenë qasje në të dhëna dhe raporte të përditësuara në çdo moment, duke mundësuar një menaxhim efektiv dhe përgjegjshmëri të lartë në administrimin e programit të studimit. <i>Evidenca42, 60.</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet lidhur me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit të institucionit në të paktën dy gjuhë, duke përfshirë gjithmonë gjuhën shqipe dhe një gjuhë të huaj (zakonisht anglisht). Kjo praktikë siguron transparencë dhe qasje të gjerë për një audiencë më të madhe, duke përfshirë studentët ndërkombëtarë dhe partnerët e huaj. <i>Evidenca 57, www.fimif.edu.al</i>			
Konkluzione	<i>UPT ka një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional të cilësisë së lartë, i cili mbulon të gjitha aspektet e nevojshme për administrimin e informacionit akademik, administrativ dhe financiar. Ky sistem siguron që të gjitha palët e përfshira, përfshirë studentët dhe personelin, të kenë qasje të drejtuar dhe të barabartë në informacione dhe dokumente relevante, duke garantuar transparencë dhe efikasitet në menaxhimin e programit të studimit. Për më tepër, funksionalitetet e avancuara të monitorimit dhe raportimit në kohë reale përmirësojnë menaxhimin dhe përgjegjshmërinë e institucioneve, duke i lejuar atyre të reagojnë në mënyrë proaktive ndaj çështjeve dhe të përmirësojnë vazhdimisht cilësinë e ofrimit të shërbimeve akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e	Institucioni përgatit raporte financiare të detajuara që përfshijnë analizën e kostove për çdo njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ky raport përfshin një plan të qartë për mbështetjen financiare të nevojshme për të siguruar që programet e studimit të vazhdojnë pa ndërprerje për të paktën një cikël të plotë studimi. <i>Evidenca 1, 9, 27, 36, 37.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 40

Dep

[Signature]

programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit përfshin të gjitha aspektet e nevojshme për funksionimin efektiv të programeve të studimit. Ai mbulon financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive, shpenzimet për bibliotekën, dhe aksesin në burimet online. Për më tepër, plani përfshin grantet dhe kontratat e shërbimeve që kontribuojnë në realizimin e programeve të studimit, si dhe projekte dhe zëra të tjerë të rëndësishëm. <i>Evidenca 34, 37, 41.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni zbaton auditime periodike për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit. Ky proces ndihmon në sigurimin e efektivitetit financiar dhe në identifikimin e fushave që mund të përmirësohen për të siguruar përdorim optimal të burimeve financiare. <i>Evidenca 37, www.upt.edu.al , https://u-transparenca.al</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UPT përgatit dhe publikon raporte vjetore mbi realizimin e buxhetit të miratuar, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e fondeve. Këto raporte përfshijnë analizë të detajuar të shpenzimeve dhe të ardhurave në nivel të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. <i>Evidenca 1, 34, 35, 37.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni siguron qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit duke garantuar se ka kapacitete të mjaftueshme financiare për ecurinë normale të tyre. Në rastet kur ka nevojë për përmirësim të situatës financiare, institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe shqyrton mundësitë për diversifikimin e burimeve të financimit për të siguruar që programet e studimit të vazhdojnë të jenë të qëndrueshme dhe të financuara mjaftueshëm. <i>Evidenca 3, 8, 9, 10, 34, 37.</i>
Konkluzione	<i>UPT ka një sistem të mirëorganizuar për menaxhimin e financave që garanton mbështetjen e nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor dhe mbështetjen e studentëve. Me planet e detajuara të financimit, auditimet periodike dhe raportet vjetore, institucioni siguron transparencë dhe qëndrueshmëri financiare. Kjo mbështetje</i>

	<i>financiare është thelbësore për garantimin e cilësisë dhe vazhdimësisë së programeve të studimit, duke përfshirë edhe përmirësimin e burimeve njerëzore, teknologjike dhe të literaturës që janë të domosdoshme për një mësimdhënie efektive dhe për mbështetjen e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura të qarta që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja deri në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Këto politika përfshijnë proceset e pranimit, përzgjedhjes, përparimit, transferimit, njohjes dhe vlerësimit të dijeve, si dhe diplomimit të studentëve. Gjithashtu, institucioni përditëson rregullisht Guidën e Studentit dhe ofron shërbime të këshillimit të karrierës përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme dhe statistika të sakta për punësimin e studentëve pas diplomimit. <i>Evidenca 1, 12, 28, 102.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit, nga hyrja deri në dalje. Këto politika sigurojnë që të gjithë studentët të kenë akses të barabartë në mundësitë akademike dhe mbështetëse, duke përfshirë proceset e pranimit, përzgjedhjes, përparimit, transferimit, njohjes dhe vlerësimit të dijeve, si dhe diplomimit. Politikat dhe procedurat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit, duke promovuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe të drejtë për të gjithë studentët. <i>Evidenca 70, 71, 86, 87.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Institucioni harton dhe publikon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve përpara çdo viti akademik. Këto kritere janë transparente dhe të qarta, duke siguruar që çdo kandidat të ketë mundësi të barabarta për pranim. Institucioni bashkëpunon ngushtë me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, duke ndjekur ligjin dhe udhëzimet përkatëse, për të garantuar një proces të drejtë dhe të rregullt. Kriteret përfshijnë gjithashtu regjistrimin e studentëve të huaj, duke promovuar një mjedis të diversifikuar dhe ndërkombëta. <i>Evidenca 67, 70, 71</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të	Institucioni siguron që kriteret dhe procedurat për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve, përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Këto informacione janë të publikuara në mënyrë të qartë dhe transparente në dokumentacionin zyrtar të institucionit, duke përfshirë faqen e internetit dhe Guidën e Studentit. Institucioni gjithashtu ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët

kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	përmes shërbimeve këshilluese dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, duke siguruar që çdo student të jetë i informuar dhe i mbështetur gjatë gjithë ciklit të tij akademik <i>Evidenca 12, 67, 68, 69, 85, 96, www.fimif.edu.al, www.upt.edu.al</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Institucioni informon publikun dhe të interesuarit përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. Këto informacione publikohen në faqen zyrtare të internetit të institucionit, në broshura informuese dhe në mediat sociale, duke siguruar që të gjithë kandidatët potencialë dhe të interesuarit të jenë të mirëinformuar për procesin e pranimit, kërkesat akademike dhe mundësitë që ofron programi i studimit. Ky proces transparence dhe informimi i vazhdueshëm ndihmon në tërheqjen e kandidatëve të kualifikuar dhe në rritjen e besimit të publikut në institucion. <i>Evidenca 67, 68, 69, 70, 71, www.upt.edu.al</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Këto kriteret janë të dizajnuara për të siguruar një proces të drejtë dhe gjithëpërfshirës, duke promovuar diversitetin dhe barazinë në programin e studimit. Informacioni në lidhje me këto kriteret është i aksesueshëm publikisht në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në materialet informuese, duke siguruar që të gjithë kandidatët e interesuar të jenë të informuar dhe të kenë mundësi të barabarta për pranim. <i>Evidenca 70, 71 www.upt.edu.al</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni harton dhe publikon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përpara çdo viti akademik. Këto kriteret janë të detajuara dhe sigurojnë që kandidatët ndërkombëtarë të kenë një proces të qartë dhe të drejtë pranimi. Informacionet për këto kriteret janë të aksesueshme në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në materialet promovuese, duke garantuar transparencë dhe mbështetje për studentët e huaj që dëshirojnë të studiojnë në këtë institucion. <i>Evidenca 1, 71.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni harton politika të ndihmës dhe bursave për shtresa në nevojë, duke siguruar mbështetje financiare për studentët që kanë vështirësi ekonomike. Këto politika synojnë të rrisin aksesin në arsim për shtresat më të marginalizuara dhe të rrisin cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Informacioni mbi këto politika është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në materialet informuese, duke siguruar transparencë dhe akses për të gjithë studentët e interesuar. <i>Evidenca 1, 3, 28, 87.</i>
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë (UPT) ka ndërtuar një sistem të mirë-organizuar për mbledhjen, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave të studentëve. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit siguron që të dhënat të jenë gjithmonë të përditësuara dhe të sigurta, duke lejuar verifikimin e lehtë nga personat e autorizuar. Përmes raporteve analitike periodike, institucioni monitoron dhe analizon cilësinë dhe progresin e studentëve nga hyrja deri në diplomim, duke përfshirë edhe të dhënat e punësimit të tyre. Ky angazhim për mbledhjen dhe</i>

	analizimin e të dhënave ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe në sigurimin e rezultateve pozitive për studentët. Institucioni gjithashtu siguron që politikat dhe strategjitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë transparente dhe publike për të gjithë të interesuarit. Objektivat dhe mekanizmat janë afishuar në faqen e internetit të UPT-së dhe raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore janë publikuar, duke ruajtur etikën akademike dhe sigurinë e të dhënave personale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni siguron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Këto informacione janë të aksesueshme përmes faqeve zyrtare të internetit, materialeve të publikuara dhe takimeve të rregullta me studentët. <i>Evidenca 12, 65, 67, www.fimif.edu.al</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Këto procedura janë të dokumentuara qartë dhe të aksesueshme në udhëzuesit e studentëve dhe përmes platformave të komunikimit të institucionit. <i>Evidenca 12, 98, www.upt.edu.al, www.fimif.edu.al</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. Këto procedura janë transparente dhe publikohen përmes udhëzuesve akademikë dhe materialeve të tjera informuese të disponueshme për studentët. <i>Evidenca 12, 60, 100.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Informacioni për këtë është i disponueshëm në faqet e internetit të institucionit dhe përmes materialeve të printuara dhe elektronike që shpërndahen në fillim të çdo viti akademik. <i>Evidenca 12, 57, 98, www.fimif.edu.al</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Këto aktivitete informuese sigurojnë që të gjithë studentët të jenë të informuar dhe të përgatitur për kërkesat dhe procedurat e programit të studimit. <i>Evidenca 9, 67, 69, www.fimif.edu.al</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 45

studimit.				
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka treguar një angazhim të qartë për të siguruar që studentët të kenë akses të plotë dhe të hollësishëm në informacionin mbi përparimin e tyre akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit. Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik janë të qarta dhe të dokumentuara mirë, duke siguruar që studentët të kuptojnë dhe ndjekin hapat e nevojshëm për suksesin e tyre akademik. Gjithashtu, institucioni ka krijuar një mjedis transparent dhe të hapur, ku studentët informohen rregullisht për procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme, vlerësimit të dijeve dhe aftësive, si dhe për kërkesat e punimit të diplomës dhe diplomimit. Përveç kësaj, udhëzuesit e posaçëm dhe takimet informuese të organizuara përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, sigurojnë që të gjithë studentët të kenë qasje në informacionin e nevojshëm për të marrë vendime të informuara dhe për të përparuar në studimet e tyre. Ky angazhim për transparencë dhe mbështetje të vazhdueshme ndihmon në krijimin e një mjedisi akademik që promovon suksesin dhe përmbytjen e objektivave arsimore të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbytjes së standardit	Nuk përmbytet	Përmbytet pjesërisht	Përmbytet kryesisht	Përmbytet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Ky informacion është i aksesueshëm përmes udhëzuesve akademikë dhe materialeve të tjera informuese që shpërndahen për studentët në fillim të çdo viti akademik. <i>Evidenca 77, 78, 96, 99, www.fimif.edu.al</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion përfshin detaje mbi objektivat e secilës lëndë, materialet mësimore të rekomanduara dhe aktivitetet formuese që ndihmojnë në arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënës. <i>Evidenca 96, 100, 101.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. Institucioni organizon takime me përfaqësues të industrisë, panairë punësimi dhe aktivitete të tjera që synojnë të lidhin studentët me mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve. <i>Evidenca 65, 66, www.upt.edu.al, www.fimif.edu.al</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky	Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 46

dhe organizimin e procesit mësimor, logjikë, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	informacion është i disponueshëm në faqet zyrtare të internetit të institucionit dhe përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit. <i>Evidenca 57, 62, 100.</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. Ky sistem siguron që studentët të kenë akses në të gjitha materialet dhe informacionet e nevojshme për të përparuar në studimet e tyre, pavarësisht vendndodhjes së tyre. <i>Evidenca 51, 58, 60.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka treguar një angazhim të fortë për të siguruar që studentët të jenë plotësisht të informuar për të gjitha aspektet e programit të studimit, duke përfshirë strukturën, organizimin, përmbajtjen dhe rezultatet e pritshme të të nxënësve. Politikat dhe procedurat e detajuara që kanë për qëllim informimin e studentëve për mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale janë të qarta dhe të aksesueshme. Përveç kësaj, sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit siguron që informacioni të jetë gjithmonë i përditësuar dhe lehtësisht i arritshëm nga të gjithë studentët, duke mbështetur kështu një mjedis të favorshëm për suksesin akademik dhe profesional të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit. Këto statistika përfshijnë të dhëna mbi regjistrimet e reja, progresin e studentëve gjatë studimeve dhe përfundimin e suksesshëm të programit. <i>Evidenca 9, 17, 43.</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi dhe largimet para përfundimit të programit. Të dhënat përfshijnë gjithashtu mospërfundimin me sukses të vitit akademik. <i>Evidenca 43, 60, 105.</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, i cili siguron që këto të dhëna të jenë të

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 47

përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Ky sistem garanton ruajtjen dhe përditësimin e informacionit në mënyrë të vazhdueshme. <i>Evidenca 60, https://bit-albania.com</i>			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni mbështet me akte kontrollin periodik të përvitshëm pranë njësive përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të studentëve. Ky kontroll përfshin vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes dhe saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit të lidhur me studentët dhe veprimtarinë e tyre akademike. <i>Evidenca 28, 45, https://bit-albania.com</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia bazë harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. Këto raporte përmbajnë analiza të hollësishme dhe sugjerime për masa përmirësuese për të rritur cilësinë dhe rezultatet e programit të studimit. <i>Evidenca 43, 75, 97</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka implementuar një sistem të mirë-organizuar për mbledhjen, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave të studentëve. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit siguron që të dhënat të jenë gjithmonë të përditësuara dhe të sigurta, duke lejuar verifikimin e lehtë nga personat e autorizuar. Përmes raporteve analitike periodike, institucioni monitoron dhe analizon cilësinë dhe progresin e studentëve nga hyrja në diplomim, duke përfshirë edhe të dhënat e punësimit të tyre. Ky angazhim për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe në sigurimin e rezultateve pozitive për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse të tyre në organet vendimmarrëse	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese sipas akteve ligjore dhe rregullatore të institucionit. Kjo përfshirje synon të sigurojë që zëri i studentëve të dëgjohet dhe të

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 48

e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	merret parasysh në proceset vendimmarrëse që ndikojnë drejtpërdrejt në përvojën e tyre akademike. <i>Evidenca 1, 2, 10, 11, 28, 89.</i>			
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni garanton që përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frytdhënëse dhe me rezultate të matshme e të verifikueshme. Studentët marrin pjesë aktive në diskutime dhe vendime që lidhen me përmirësimin e programeve të studimit dhe metodave të mësimdhënies. <i>Evidenca 12, 25, 28, 89, 90, 96.</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Njësia përgjegjëse siguron përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta, duke reflektuar sugjerimet dhe kontributin e tyre përmes mbledhjeve të përbashkëta, pyetësorëve dhe grupeve të fokusit. Ky angazhim i vazhdueshëm garanton që programet e studimit të jenë gjithmonë në përputhje me nevojat dhe pritshmëritë e studentëve. <i>Evidenca 25, 89, 90.</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Nga takimi me studentët si dhe kodi i etikës e dokumentat e tjera të vëna në dispozicion, GVJ konstaton se studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit, njesisë apo pedagogut përgjegjës. Kjo transparencë dhe mundësi për ankimim siguron një proces të drejtë dhe të ndershëm për të gjithë studentët. <i>Evidenca 2, 12.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka ndërtuar një sistem të fortë për përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese. Këto politika dhe procedura sigurojnë që studentët të kenë një rol aktiv dhe efektiv në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit dhe metodave të mësimdhënies. Përfshirja e tyre e rregullt dhe konstruktive ndihmon në rritjen e cilësisë së edukimit dhe garanton një mjedis akademik transparent dhe të drejtë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka	Institucioni ka procedura dhe njësi të posaçme për informimin dhe

procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	shërbimin e studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Këto procedura përfshijnë mirëprirjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve që nga hyrja deri në përfundim të studimeve. <i>Evidenca 57, 58, 66, 67, 68.</i>			
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka ngritur dhe funksionalizuar një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve. Ky sistem është i orientuar drejt asistimit të studentëve për çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme. <i>Evidenca 9, 18, 19, 60, 85, 86, 96, www.upt.edu.al, www.fimif.edu.al</i>			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/ njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. <i>Evidenca 9, 57, 65, 66.</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Këto të dhëna i vihen në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse, duke ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe mbështetjes për studentët e diplomuar. Kjo zyre ofron mbështetje të plotë për studentët në çdo fazë të studimeve të tyre. <i>Evidenca 6, 75.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka ndërtuar një sistem të mirëorganizuar për të mbështetur studentët gjatë gjithë ciklit të tyre akademik. Procedurat dhe njësitë e posaçme për pritjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve janë lehtësisht të arritshme dhe funksionojnë në mënyrë të përhershme, duke siguruar një mbështetje të plotë për studentët në çdo fazë të studimeve të tyre</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Në nivel institucional, UPT, është e angazhuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe rolin e saj në komunitet. Për këtë qëllim, janë hartuar një sërë procedurash dhe akte rregullatore të brendshme për të unifikuar qasjen dhe organizmin brenda njësive homologe në të gjithë institucionin. Në kuadër të rritjes së cilësisë, kjo garanton që procedurat e ndjekur për avancimin akademik, rekrutimin e stafit, hartimin apo modifikimin e planeve mësimore dhe aktivitetet të ndryshme në njësitë kryesore dhe ato bazë, të jenë procedura të qarta dhe uniforme në nivel institucioni. Gjithashtu, në përfundim të vitit akademik njësia bazë harton një raport sraport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SËOT, si dhe masat e marra për përmirësim në të ardhmen. <i>Evidenca 17, 25, 42, 43, 84.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni i arsimit të lartë siguron një politikë të qartë për të garantuar dhe promovuar cilësinë e mësimdhënies përmes hartimit të udhëzuesve të posaçëm dhe metodave të monitorimit. Strukturat përgjegjëse brenda institucionit zhvillojnë dhe implementojnë mekanizma të rregullt monitorimi, të cilët vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Ky proces i vazhdueshëm i vlerësimit ndihmon në identifikimin e praktikave të mira dhe promovon përmirësimin e mëtejshëm të metodave të mësimdhënies. <i>Evidenca 9, 12, 25, 94.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Nga vizita në institucion rezulton se studentët janë të përfshirë në vlerësimin periodik të stafit akademik. Studentët luajnë një rol kryesor në vlerësimin e stafit akademik. Në fund të semestrit studentët plotësojnë pyetësoren e kontrollit të cilësisë, (vlerësimit të brendshëm). Studentët kanë të drejtë të ankimohen dhe dekanati në bashkëpunim me departamentin shqyrtojnë ankesën dhe i japin zgjidhje asaj. UPT ka hartuar edhe një broshurë të shkurtër e cila përmbledh shërbimet e ofruara në UPT. <i>Evidenca 25.</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë	Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore të institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë akademike, kodin

publike rezultatet e vlerësimit.	e etikes dhe sigurinë e të dhënave personale. Raporte të cilat ruhen në arkivën institucionale konform akteve rregullatore në fuqi. <i>Evidenca 17, 25, 43, 92.</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga vizita në institucion rezulton se IAL ka si parim vlerësimin dhe promovimin e praktikave të mira në mësimdhënie përmes mjeteve të tij të komunikimit siç janë e-mail, platformat e komunikimit dhe mësimin on-line Microsoft, Teams etj. Analiza e pyetësorëve, si në nivel Universiteti, ashtu edhe njësie bazë, ka për qëllim promovimin e praktikave më të mira, nxitjen e vazhdimësisë së tyre, dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. <i>Evidenca 22, 23, 24.</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Politeknik i Tiranës ka një qasje të strukturuar dhe të dokumentuar për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Me politika dhe procedura të qarta, si dhe me përfshirjen e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm, institucioni siguron një sistem të qëndrueshëm për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë. Përdorimi i treguesve të matshëm dhe promovimi i arritjeve më të mira kontribuojnë në një mjedis akademik që nxit përmirësime të vazhdueshme dhe ruan standardet e larta të mësimdhënies dhe kërkimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universitetit Politeknik të Tiranës për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka hartuar politika në nivel institucional, si dhe ka ngritur strukturat përkatëse deri në nivel njësie bazë, të cilat merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të duhur. Strukturat e ngritura dhe procedurat e ndjekura janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe me Manualin “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”. <i>Evidenca 6, 75, https://www.upt.al/dega-mesimore</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të	Në UPT është ngritur dhe funksionon Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë me një drejtori të dedikuar këtij qëllimi në nivel rektorati. Kjo drejtori në bashkëpunim me “Drejtore të Kurrikulave”, “Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit” dhe “Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve” në varësi të Rektoratit UPT, kanë në fokus primar informimin e organeve vendimmarrëse të UPT në lidhje me gjendjen aktuale të të gjithë sektorëve respektive, dhe të japin vlerësimin e tyre për përmirësime në vijim.

jashtëm.	Senati Akademik është organi përgjegjës për vendimmarrjen në UPT dhe studentët janë të përfaqësuar në këtë organ me 4 përfaqësues të zgjedhur mes tyre. Mirëfunksionimi i sistemit të brendshëm të cilësisë është vlerësuar edhe nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, e cila me vendimin e Bordi i Akreditimit Nr. 01, datë 07.01.2022 ka vendosur “Akreditimin institucional të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti Politeknik i Tiranës, me kohëzgjatjen prej 6 (gjashtë) vite deri më 06/01/2028. <i>Evidenca 1,2,3, 9, 11, 12, 24, 27</i>			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UPT në kuadër të sigurimit të cilësisë i kushton një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik me tituj e grada shkencore, me eksperiencë në fushën përkatëse. Trajnimi i stafit akademik është një element i rëndësishëm i politikave të institucionit për ruajtjen dhe rritjen e mëtijshme të sigurimit të cilësisë. Zakonisht në fillim të vitit akademik, por edhe gjatë tij, realizohen trajnime me personelin akademik, në disa raste edhe me lektorë të huaj, për çështje të tilla që lidhen me teknologjitë e mësimdhënies, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, etj. Nga FIMIF është organizuar Konferencë ndërkombëtare dhe parashikohet të organizohet një tjetër në shtator. Instrumentat e shumta, si pyetësorët me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një <i>feedback</i>-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme. <i>Evidenca 3, 29, 4, 44, 94.</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni ka vendosur tregues të qartë dhe të matshëm për vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit. Këta tregues përdoren për të pasqyruar gjendjen aktuale, arritjet dhe dobësitë në programin e studimit. Në bazë të këtyre treguesve, institucioni promovon dhe shpërblen arritjet më të mira, duke nxitur përmirësime të vazhdueshme në cilësinë e programeve të studimit. <i>Evidenca 14, 15, 16, 22, 23, 24.</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) përmbush këto kritere duke ngritur dhe duke mbajtur në funksion një Sistem të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Kjo përfshin një drejtori të posaçme të përkushtuar për këtë qëllim dhe një strategji institucionale për përmirësimin e cilësisë së vazhdueshme, duke përfshirë pjesëmarrjen e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm. Institucioni gjithashtu përdor instrumente të përshtatshme dhe tregues të qartë për të monitoruar dhe siguruar cilësinë në mësimdhënie dhe kërkim. Ky përkushtim dhe strukturë e qartë e vendos UPT-në në përputhje me standardet e përcaktuara për Sigurimin e Brendshme të Cilësisë në arsimin e lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Çdo fillim viti akademik bëhet përditësimi i syllabuseve nga titullarët e lëndës në bashkëpunim me lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët. Ky aktivitet zhvillohet nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, dhe me Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti. U konstatua se në përbërje të grupit kishte personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Gjithashtu në grupin e ekspertëve kishte përfaqësues nga bota e biznesit. I gjithë dokumentacioni i plotë i programit të studimit për vitin pasardhës, mbasi është miratuar në njësinë bazë, përcillet në njësinë kryesore e cila i përcjell ato pranë Drejtorisë së Kurrikulave pranë Rektoratit. Rezultatet e vlerësimeve nga pyetësorët e studentëve , të realizuara nga sektori i Statistikës dhe Informacionit konform rregullores së brendshme, dokumentohen në formë shkresore, përpunohen dhe i dërgohen të gjitha instancave përkatëse. Kështu, pas realizimit të focus grupeve, informacioni i dërgohet Rektoratit dhe çdo njësie bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, informacioni me problematikat përkatëse dërgohet në fakultet, departament, të cilet i diskutojnë në mbledhje të posatshme dhe ia komunikojnë në mënyrë konfidenciale personelit akademik. Për më tepër, të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e studentëve diskutohen edhe në mbledhje të Senatit Akademik. <i>Evidenca 25, 43, 92, 94, Dokumentacioni shtesë 3.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Në raportin e vlerësimit të hartuar nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT, përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, që mbulon departamenti, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SËOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen. <i>Evidenca 25, 43, 94.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit,	Pjesë e metodave të vlerësimit janë edhe vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës, apo edhe kërkesave të personelit akademik, apo studentëve kur vlerësohet si e domosdoshme.

vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<i>Evidenca 42, 77, 78, 92.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Pyetësorët e realizuara me studentët aktualë janë periodike, dy herë në vit. Ndërkohë, në nivel universiteti, fakulteti të realizohen pyetësor me personelin akademik, për të marrë përshtypjet e tyre në lidhje me çfarë i ofron Institucioni dhe sa të kënaqur janë ata etj. Pjese e metodikës është edhe gjurmimi i ALUMNI i realizuar edhe ne projektin GRADUA ku UPT është anëtar. <i>Sugjerohet që të zgjerohen fasha e metodave të tërthorta për vlerësimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimit, duke marrë mendimet dhe opinionet e palëve të tjera, të interesuar për dijet dhe kompetencat e situara në këtë program studimi.</i> <i>Evidenca 25, 75, 94.</i>
Konkluzione	<i>UPT ka ndërtuar një sistem të mirë-organizuar për monitorimin dhe vlerësimin periodik të programeve të studimit përmes njësisë të posaçme, duke garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve. Mekanizmat dhe proceset e përdorura janë formale dhe të dokumentuara, duke përfshirë përditësimin e syllabuseve nga titullarët e lëndës në bashkëpunim me lektorët dhe asistent-lektorët, dhe realizohen nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Grupit të Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti. Rezultatet e vlerësimeve të realizuara nga pyetësorët e studentëve dhe sektori i Statistikës dhe Informacionit përpunohen dhe i dërgohen të gjitha instancave përkatëse, duke përfshirë Rektoratit dhe njësitë bazë, për marrjen e masave për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Këto të dhëna diskutohen në mbledhje të posatshme dhe i komunikohen personelit akademik në mënyrë konfidenciale, duke siguruar një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të cilësisë.</i> <i>Raportet e vlerësimit përfshijnë të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik, literaturën e re, rezultatet e studentëve, marrëveshjet e bashkëpunimit dhe veprimtarinë kërkimore shkencore. Analiza SËOT dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen janë gjithashtu pjesë e këtyre raporteve. Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, duke</i>

	përfshirë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, didaktikës, kurrikulës, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor, testime lokale apo të standardizuara dhe rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Matematike, institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to. Në grupin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të programit të këtij programi studimi dhe një përfaqësues i studentëve. <i>Evidenca 1, 4, 5.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ, nisur nga dosja e vënë në dispozicion nga institucioni, vëren se vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë në nivel institucional por edhe njësie bazë dhe kryesore, ka sherbyer për të përcaktuar objektivat të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara në tërësi e pasqyruar kjo edhe në hartimin e objektivave të zhvillimit strategjik institucional dhe të njësisë kryesore. Në rritjen e përfshirjes së studentëve në organet kolegjiale vendim marrëse, edhe organeve rregullatore, në UPT është e miratuar një rregullore specifike për perzgjedhjen dhe organizimin në sigurimin e brendshëm të cilësisë nga radhet e stafit akademik e studenteve. <i>Evidenca 18, 19, 25, 68.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në procedurat e vlerësimit të cilësisë marrin pjesë të gjithë aktorët, të cilët kanë një ndikim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin e programit të studimit. Njësia bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional. Në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT janë përcaktuar përgjegjësit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, grupet e cilësisë së njësive bazë, përfshirja e gjykimit të studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, etj. Gjithashtu nga vizita në institucion, takimet me përgjegjësen e departamentit, dekanin dhe NJSBC, rezultojnë se garantohej përfshirja e të gjitha instancave në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së këtij programi studimi. <i>Evidenca 27, 43, 92.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe	Institucioni respekton të drejtat themelore të çdo pale të përfshirë në

aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	jetën universitare, si dhe respekton Kodin e Etikës të UPT. Ngritja e grupit të vlerësimit të brendshëm bëhet mbi bazën e shmangies të konfliktit të interes me postin që ata mbajnë. <i>Evidenca 2, 84..</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në kuadër të vlerësimeve periodike të programeve të studimit, një vëmendje e veçantë i kushtohet sugjerimeve dhe rekomandimeve të dhena nga ekspertët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Gjithashtu, në fazën e rishikimit të programeve të studimit, brenda masës së lejuar deri në 20%, Institucioni herë pas herë angazhon edhe ekspertë të jashtëm nga PAK dhe nga prania e ekspertëve të fushës nga institucionet ku studentet kryejnë praktikën. Pjesë e vlerësimit gjithë përfshirës është edhe analiza e përputhshmërisë së planit mësimor dhe syllabuseve përkatëse me atë të ofruar në IAL të ngjashme jashtë vendit. <i>Evidenca 31, 39, 75, 76, 91.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka arritur të përmbushë këtë në një standard në shkallë të plotë, duke garantuar një përfshirje të gjerë dhe të mirëorganizuar të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në proceset e sigurimit të cilësisë së programit të studimit, si dhe duke informuar palët e interesuara për rezultatet dhe masat e marra.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe strategjia mbi të cilën funksionon sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT, janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional. Objektivat dhe mekanizmat të cilat janë publike për të gjithë të interesuarit dhe të afishuara edhe në faqen e internetit të UPT në zërin e “Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. UPT dërgon pranë MASR raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore të Institucionit, si dhe e bën publike për të gjithë të interesuarit në faqen ëeb. <i>Evidenca 31, www.upt.al</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore të institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë akademike, kodin e etikës dhe sigurinë e të dhënave personale. Raporte të cilat ruhen në arkivën institucionale konform akteve rregullatore në fuqi. <i>Evidenca 13, 43,44, www.upt.al</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit	Raporti vjetor i FIMIF dhe DIM përfshin të dhëna mbi masat e marra

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 57

duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	nga planveprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik. Në këtë program studimi nuk ka pasur ndryshim të kurrikulës në tre vitet e fundit akademike. <i>Evidenca 90.</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Matematike. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se ka një ndryshim cilësor në këtë drejtim, krahasuar me vlerësimin e parë Institucional. Drejtesit e njësisë bazë, njësisë kryesore dhe të institucionit kanë bërë përpjekje serioze për përmirësimin e cilësisë së këtij program studimi. Nga analiza e bërë na rezulton se një pjesë e masave të marra kanë qenë efektive dhe kanë dhënë rezultat. <i>Evidenca 25.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në nivel institucional, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon në mënyrë periodike seanca informuese/trajnuese me stafin akademik dhe atë administrativ për rritjen e vetëdijes institucionale rreth përmirësimin afatgjatë të cilësisë. DIM, pedagogët koordinatorë për çdo program studimi, në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese, si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm, informonin studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. <i>Evidenca 96.</i>			
Konkluzione	<i>UPT përmbush këto kritere duke publikuar politikat dhe strategjitë e tyre për Sigurimin e Cilësisë në faqen e tyre zyrtare në internet dhe duke raportuar rregullisht për veprimtarinë e tyre mësimore dhe kërkimore. Institucioni gjithashtu organizon aktivitete periodike për të informuar dhe trajnuar stafin akademik dhe studentët në lidhje me rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë në programet e tyre të studimit. Ky përkushtim për transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm vërteton angazhimin e tyre për të arritur standardet e përcaktuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinierinë Matematike” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Niveli i lartë i kualifikimit të stafit akademik, përvoja dhe eksperiencia e gjatë në mësimdhënie përbëjnë pikat më të forta të PSBIM.
2. Përditësimi i syllabuseve dhe planit mësimor për tu përshtatur me ndryshimet dhe zhvillimet e fundit.
3. Mosha mesatare e stafit akademik relativisht e re favorizon ecurinë dhe perspektivën e institucionit.
4. Struktura përgjegjëse e PSBIM, DIM, është e mirëorganizuar, dinamike, aktive dhe komunikuese. DIM është departamenti më i madh në UPT, me lidhje dhe shërbime të shumta brenda universitetit.
5. PSBIM ofron përkujdesje të veçantë ndaj studentëve përmes mentorimit të vazhdueshëm gjatë viteve akademike.
6. Nga viti 2013, PSBIM ka krijuar modele të suksesit, duke përfshirë diplomantë që tashmë janë kolegë në UPT dhe në universitete dhe institute të tjera brenda dhe jashtë vendit.
7. DIM ofron vijueshmëri në studime nga cikli Bachelor ne Master dhe po bën përpjekje që të shtrij më tej këtë vijueshmëri me programet Doktorale.
8. PSBIM ofron ambiente bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor, përfshirë salla leksionesh, seminare, laboratorë, infrastrukturë mësimore dhe pajisje logjistike të nevojshme. Gjithashtu, ofron një bibliotekë me abonim elektronik në MathSCiNet dhe laboratorë të dedikuar me paketa softuerike specifike për programin e studimit.
9. PSBIM përdor një sistem elektronik funksional për menaxhimin e informacionit, që kontribuon në administrimin e brendshëm institucional dhe në veçanëri në procesin e mësimdhënies.
10. DIM nëpërmjet PSBIM, është në përpjekje të vazhdueshme për të inovuar dhe për të kontribuar në fushën e hulumtimit në Matematikë dhe Informatikë, duke përfshirë bashkëpunime aktive me industrinë dhe zhvillimet e fundit në teknologji dhe zbatimin e matematikës në këto zhvillime.

Pika të dobta:

1. Mungesa e qendrueshmërisë në regjistrimin dhe përfundimin e studimeve nga ana e studentëve.
2. Rishikimi dhe rifreskimi i syllabuseve me literaturë të pesë viteve të fundit në lëndët që është e mundur.



Rekomandime:

1. Përfshirja e studentëve në projekte të departamentit.
2. Krijimi i mundësive për diploma të dyfishta.
3. Hartimi dhe vënia në zbatim e një plani marketingu lidhur me programin e studimit, me qëllim rritjen e numrit të studentëve të cilët regjistrohen.
4. Diversifikimi i praktikave mësimore. T'ju mundësohet praktika edhe në kompanitë e tjera me të cilat institucioni ka marrëveshje.
5. Rishikimi i syllabuseve për lëndët e vitit të parë (siç është vepruar me algjebërën), në mënyrë që të ndihmohen studentët të kapërcejnë boshlleqet nga gjimnazi.
6. Rishikimi dhe rifreskimi i syllabuseve me literaturë të pesë viteve të fundit në lëndët që është e mundur.
7. Të ulet pak ngarkesa javore e studentëve pasi e kalon 25 orë në javë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
8. Rishikimi në rregullore i detyrimeve paraprake të studentëve për të hyrë në provim pasi detyrimet ekzistuese zgjasin kohën e diplomimit të tyre.



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Mathematical Engineering" provided by the Higher Education Institution "Polytechnic University of Tirana"

Strengths and Affirmations:

1. The high qualification level of the academic staff, along with their extensive experience and long teaching tenure, are the strongest points of the Bachelor in Mathematical Engineering (PSBIM) program.
2. Regular updates to the syllabi and curriculum to adapt to recent changes and developments.
3. The relatively young average age of the academic staff enhances the progress and perspective of the institution.
4. The responsible structure for the PSBIM, the Department of Mathematics and Informatics (DIM), is well-organized, dynamic, active, and communicative. DIM is the largest department in UPT, with numerous connections and services within the university.
5. PSBIM offers special care to students through continuous mentoring during the academic years.
6. Since 2013, PSBIM has created success models, including graduates who are now colleagues at UPT and in other universities and institutes both inside and outside the country.
7. DIM ensures continuity in studies from the Bachelor to the Master cycle and is making efforts to extend this continuity to Doctoral programs.
8. PSBIM provides modern facilities for the teaching process, including lecture halls, seminar rooms, laboratories, educational infrastructure, and necessary logistical equipment. It also offers a library with electronic subscriptions to MathSciNet and dedicated laboratories with specific software packages for the study program.
9. PSBIM uses a functional electronic system for information management, which contributes to internal institutional administration and particularly to the teaching process.
10. Through PSBIM, DIM continuously strives to innovate and contribute to research in Mathematics and Informatics, including active collaborations with the industry and the latest developments in technology and the application of mathematics in these developments.

Weaknesses:

1. Lack of consistency in registration and completion of studies by students.
2. Revising and refreshing the syllabuses with literature of the last five years in the subjects that is possible.



Recommendations:

1. Involvement of students in departmental projects.
2. Creating opportunities for double degrees.
3. Designing and implementing a marketing plan related to the study program, in order to increase the number of students who register.
4. Diversification of teaching practices. To enable you to practice in other companies with which the institution has an agreement.
5. Revision of syllabi for first-year subjects (as done with algebra), in order to help students bridge gaps from high school.
6. Revising and refreshing the syllabuses with literature of the last five years in the subjects that is possible.
7. The weekly load of students should be slightly reduced since it exceeds the 25 hours per week provided by the legislation in force.
8. Revision in the regulations of the preliminary obligations of students to enter the exam, since the existing obligations extend the time of their graduation.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X